



**ILD**

INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË

**PËR PUNËN E ZYRËS SË  
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

**PËR PERIUDHËN  
01.01.2022 – 31.12.2022**

## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| <b>I. HYRJE</b> .....  | 6  |
| 1.1. Vizioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbushje të veprimtarisë .....  | 6  |
| <b>II. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË</b> .....       | 7  |
| 2.1. Referenca Ligjore.....  | 7  |
| 2.2. Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....  | 8  |
| <b>III. VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET</b> .....   | 11 |
| 3.1. Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....   | 11 |
| 3.1.1. Të dhënat për ankuesit .....  | 12 |
| 3.1.2. Të dhëna për subjektin .....  | 12 |
| 3.2. Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave.....  | 13 |
| 3.3. Hetimet Disiplinore .....   | 16 |
| 3.4. Ankime kundër vendimeve të arkivimit dhe hetimit .....  | 18 |
| 3.5. Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave .....  | 19 |
| 3.6. Ecuria e trajtimit të ankesave <i>backlog</i> .....   | 22 |
| 3.7. Inspektimet tematike .....  | 23 |
| <b>IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR</b> .....   | 29 |
| 4.1. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë/KPK .....    | 29 |
| 4.2. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Prokurori i Përgjithshëm.....   | 30 |
| 4.3. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë.....                                       | 31 |
| 4.4. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme .....                   | 32 |
| 4.5. Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile.....   | 32 |
| 4.6. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë.....                                       | 33 |
| 4.7. Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtare, në kuadër të procesit për integrimin evropian .....             | 34 |
| <b>V. ORGANIZIMI I BRENDSHËM</b> .....   | 36 |
| 5.1. Komandime nga KLGJ .....  | 36 |
| 5.2. Komandime nga KLP .....   | 36 |
| 5.3. Rekrutim i inspektorëve jomagjistrat .....  | 37 |
| 5.4. Zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore ..... | 37 |

|              |   |    |
|--------------|---|----|
| <b>5.5.</b>  | <b>Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve</b> .....  | 38 |
| 5.5.1.       | <i>Shkëmbime eksperiencash</i> .....  | 39 |
| 5.5.2.       | <i>Pjesëmarrje në konferenca shkencore</i> .....  | 40 |
| 5.5.3.       | <i>Veprimtari trajnuese</i> .....   | 41 |
| <b>VI.</b>   | <b>TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE</b> .....  | 42 |
| <b>6.1.</b>  | <b>Procese në Kolegjin e Posaçëm të Apelit</b> .....  | 42 |
| 6.1.1.       | <i>Çështje të përfunduara</i> .....   | 42 |
| 6.1.2.       | <i>Çështje në proces shqyrtimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit</i> .....  | 43 |
| <b>6.2.</b>  | <b>Procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë</b> .....   | 44 |
| <b>6.3.</b>  | <b>Procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë</b> .....  | 44 |
| <b>VII.</b>  | <b>TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN</b> .....  | 45 |
| <b>7.1.</b>  | <b>Transparenca në fokus të veprimtarisë</b> .....  | 45 |
| <b>7.2.</b>  | <b>Faqja e internetit si mënyrë komunikimi e institucionit</b> .....  | 47 |
| <b>7.3.</b>  | <b>Pritja e qytetarëve në mjediset e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë</b> .....   | 47 |
| <b>7.4.</b>  | <b>E drejta e informimit</b> .....  | 47 |
| <b>7.5.</b>  | <b>Si komunikon ILD me publikun?</b> .....  | 49 |
| <b>7.6.</b>  | <b>Komunikimi me median si mënyrë për të arritur tek publiku</b> .....  | 50 |
| <b>VIII.</b> | <b>PERFORMANCA FINANCIARE</b> .....   | 52 |
| <b>IX.</b>   | <b>PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE</b> .....  | 54 |
| <b>X.</b>    | <b>PRIORITETE GJATË VITIT 2023</b> .....  | 57 |
| <b>XI</b>    | <b>NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2021.</b> ..... | 58 |

## MESAZH I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

*E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit,*

*Të nderuar deputetë,*

Kam kënaqësi të ndaj me ju, për herë të tretë gjatë ushtrimit të kësaj detyre, raportin e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022.

Siç do të vëreni edhe gjatë leximit të këtij raporti, ILD si institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, ka patur një vit intensiv pune me sfida dhe rezultate konkrete. Raporti në mënyrë të detajuar ka paraqitur këtë ecuri të veprimtarisë së institucionit për vitin 2022, por në këtë mesazh hyrës të raportit, dëshiroj të ndaj me ju, se:

Edhe gjatë 2022-shit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është mundur të prekë çdo dimension të punës së vet, çdo aspekt që bën të mundur funksionalitetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si institucion verifikues i ankesave ndaj punës së magjistratëve, por edhe si institucion publik, me detyrimet që parashikon ligji. ILD ka trajtuar aspekte të punës që nga infrastruktura fizike, e teknologjisë së informacionit, rregullatorë e strukturorë, arkiva, e më tutje tek ankesat, inspektimi e procedimi disiplinor, fuqizimi i kapaciteteve, marrëdhëniet me institucionet e organizata vendase dhe homologë ndërkombëtarë, transparencën dhe deri te komunikimi publik, jo vetëm për punën e funksionet e ILD-së, por edhe diskutime më të gjera, ku ILD ka dhënë mendimin e tij për sfidat dhe balancat e rëndësishme që duhen mbajtur në një shoqëri demokratike ndërmjet interesave legjitime, siç është interesi publik për administrimin e drejtësisë dhe ndarja e pushteteve dhe pavarësia e magjistratëve.

Kemi patur prioritet këtë vit uljen dhe reduktimin e ndjeshëm të backlog-ut, fondit të ankesave/dosjeve të trashëguara nga institucionet e tjera, që i administronin ato para ngritjes së ILD-së, sepse për ne është e rëndësishme shmangia e kulturës së harresës e pandëshkueshmërisë, që do vinte edhe përmes parashkrimit të ankesave që qytetarët kishin paraqitur përpara ngritjes së institucionit të ILD. Pra, çdo qytetar apo institucion ankues do marrë përgjigje për pretendimet e paraqitura, qoftë edhe para disa vitesh dhe në institucione të tjera.

Me gjithë burimet jo të plota të inspektimit, puna ka vijuar paralelisht, edhe me inspektimet tematike në gjykata e prokurori, ashtu edhe me trajtimin e ankesave të ardhura direkt në institucion, të cilat kanë çuar në 6 procedime disiplinore gjatë këtij viti, ndërsa prej marrjes së detyrës janë 83 magjistratë të hetuar disiplinorisht nga zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Me kënaqësi evidentojmë se puna monitoruese dhe disiplinore e ILD-së ka rritur ndërgjegjësim të magjistratëve për cilësinë e vendimmartjes së tyre, ndërsa pas tre vitesh, standardet e vendosura në punën e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e procedimin disiplinor janë konfirmuar si nga Këshillat, Këshilli i Lartë Gjyqësor e Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ashtu edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit. Dëshiroj të sjell në vëmendje se as gjatë vitit 2022, nuk ka patur asnjë pretendim të ngritur ndaj ILD-së, ndaj veprimtarisë hetimore të institucionit, për shkaqe jashtë atyre që parashikon ligji, duke dhënë kështu mesazhin garantues se institucioni i ILD do të ndjekë me përpikmëri Kushtetutën dhe ligjin.

Gjatë veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, siç do të shikohet në raport, ka patur intensitet, ka patur rezultate, ka patur sfida dhe vështirësi, ka patur problematika për të cilat mund të ishte punuar akoma më shumë. Por, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mbetet e rëndësishme puna me standarde kushtetuese dhe ligjore, si të vetmet themele solide për funksionimin demokratik të sistemit të drejtësisë.

Me respekt,  
Artur Metani  
Inspektor i Lartë i Drejtësisë

## I. HYRJE

### 1.1. Vizioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbushje të veprimtarisë

Vizioni i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, udhëhiqet nga parimet dhe vlerat e sistemeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, të tilla si ushtrimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur ndaj çdo lloj ndikimi duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe kompetencave të dhëna me ligj, ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të paanshme, të përgjegjshme, llogaridhënese, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore, me efikasitet dhe profesionalizëm, të besueshme, transparente dhe të aksesueshme prej publikut, si dhe bashkëpunuese në nivel institucional.

Nën dritën e vizionit të veprimtarisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, drejton punën përmes katër objektivave të rëndësishme:

- Fuqizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, efikente dhe profesionale;
- Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare;
- Pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në Institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për qëllime të zbatimit në praktikë të objektivave të punës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar strukturën organizative të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, e cila është konceptuar për të funksionuar në respektim të parimeve të hierarkisë, llogaridhënies, ligjshmërisë, efektivitetit, paanësisë dhe mosdiskriminimit si dhe të bashkëpunimit, në përmbushjen e misionit Kushtetues e ligjor për të arritur objektivat e sipërpërmendura.

## II. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

### 2.1. Referenca Ligjore

Inspektori i Lartë të Drejtësisë është një organ i pavarur kushtetues, i ngritur në përputhje me nenin 147/d të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Organizimi dhe funksionimi i institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rregullohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 536, datë 25.7.2019, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”;
- Vendimi nr. 28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbështetet midis të tjerash në:

- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

- Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjin për buxhetin vjetor;
- Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- Ligjin nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”;
- Vendimin nr. 972, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin të kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”;
- Vendimin nr. 971, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë”;
- Vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme”.

## 2.2. Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në funksion të zbatimit të kompetencave ligjore dhe përmirësimit të veprimtarisë për vitin 2022, janë hartuar dhe miratuar në total 22 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit, menaxhimit dhe kontrollit financiar<sup>1</sup>.

Krahas urdhrave të përgjithshëm, është miratuar edhe 1 vendim ndryshues në funksion të miradministrimit të proceseve inspektuese.

Sa i takon urdhrave të përgjithshëm administrativë, ndër më të rëndësishmit, rendisim sipas kategorive:

### I - Organizim dhe funksionim:

1. Urdhër nr. 4, datë 10.01.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
2. Urdhër nr. 24, datë 15.03.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për organizimin e takimit të punës me temë: “Hartimin e planit të veprimit për shqyrtimin e ankesave (backlog) dhe përcaktimin e detyruar të detyrave dhe strukturave përkatëse për hartimin e vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kuadër të verifikimit dhe hetimit të

<sup>1</sup> Urdhrat janë të aksesueshëm në linkun: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>



- shkeljeve disiplinore”;
3. Urdhër nr. 31, datë 16.05.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të veprimit të rishikuar, në zbatim të objektivave strategjike të përcaktuar nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, për planin strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022”.
  4. Urdhër nr. 43, datë 15.04.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 14, datë 27.01.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për mënyrën e raportimit dhe monitorimit të planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””.
  5. Urdhër nr. 43/1, datë 16.05.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e komisionit të monitorimit dhe raportimit të strategjisë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
  6. Urdhër nr. 47, datë 24.05.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e formatit të librit të brendshëm të dorëzimit dhe qarkullimit të projektvendimeve dhe vendimeve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
  7. Urdhër nr. 49, datë 30.05.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e programit për informimin dhe komunikimin publik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
  8. Urdhër nr. 56, datë 07.07.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullave të sjelljes dhe standardeve të etikës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
  9. Urdhër nr. 57, datë 07.07.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 119, datë 12.07.2021 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””;
  10. Urdhër nr. 59, datë 15.07.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore (SMAD) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
  11. Urdhër nr. 63, datë 28.07.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit 2023-2025, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
  12. Urdhër nr. 33/1, datë 04.11.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmësinsektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
  13. Urdhër nr. 99, datë 16.11.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e punonjësit në rolin e administratorit energjetik gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”;
  14. Urdhër nr. 100, datë 16.11.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për shpërndarjen e ankesave të patrajtuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
  15. Urdhër nr. 102, datë 23.11.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 33/1, datë 04.11.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmësinsektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””;

16. Urdhër nr. 121, datë 30.12.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e metodologjisë së inspektimit”;
17. Urdhër nr. 122, datë 30.12.2022 “Për përcaktimin e rregullave për shqyrtimin e ankesave në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
18. Vendim nr. 7, datë 22.02.2022 , i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit vjetor të pranimit për vitin 2022, për pozicionet pjesë e shërbimit civil, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
19. Vendim nr. 57, datë 30.12.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për një ndryshim në vendimin nr. 38, datë 08.06.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve””.

## II - Menaxhimin dhe kontrollin financiar:

1. Urdhër nr. 9, datë 26.01.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara dhe shërbimeve për vitin 2022”;
2. Urdhër nr. 27, datë 18.03.2022 “Për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”;
3. Urdhër nr. 69, datë 14.09.2022 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 160, datë 13.12.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores së menaxhimit të aktiveve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
4. Urdhër nr. 106, datë 13.12.2022 “Për inventarizimin e aktiveve të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
5. Urdhër nr. 107, datë 23.12.2022 “Për caktimin e specialistit të fushës për procedurën “Supervizion dhe mbikëqyrje për rikonstruksionin e godinës””;

Ndërsa në lidhje me veprimtarinë inspektuese, rezulton 1 vendim si më poshtë:

Vendim nr. 43, datë 03.10.2022, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1, datë 11.02.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të Gjykatave dhe Zyrave të Prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht””, të ndryshuar.

### III. VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET

#### 3.1. Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Referuar veprimtarisë e në funksion të përmbushjes së parashikimeve të mësipërme ligjore, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2022, vihet re një numër i lartë ankesash të paraqitura.

Gjatë këtij viti janë depozituar **789** ankesa të reja, të ndara këto sipas subjekteve ankuese rezulton:

- **756** ankesa të depozituara nga persona fizikë;
- **33** ankesa të depozituara nga persona juridikë;

Viti 2021 është mbyllur me **2678** ankesa në proces. Shqyrtimi i tyre ka vijuar edhe gjatë vitit 2022, si shtesë ndaj numrit prej **789** ankesave të reja të depozituara në vitin 2022, duke numëruar në total **3467** ankesa objekt shqyrtimi. Nga **3467** ankesa objekt shqyrtimit gjatë vitit 2022, janë shqyrtuar **1715<sup>2</sup>** ankesa.

Tabela nr. 1 Të dhënat mbi ankesat gjatë vitit 2022

| Ankesa të mbartura nga viti 2021 | Ankesa të depozituara gjatë vitit 2022 | Ankesa objekt shqyrtimi gjatë vitit 2022 | Ankesa të shqyrtuara gjatë vitit 2022 | Mbartur për shqyrtim gjatë vitit 2023 |
|----------------------------------|--|--|---------------------------------------|---------------------------------------|
| <b>2678</b>                      | <b>789</b>                             | <b>3467</b>                              | <b>1715</b>                           | <b>1752</b>                           |

Tabela nr. 2 Ecuria e trajtimit të ankesave backlog gjatë vitit 2022

| Ankesa objekt shqyrtimi për vitin 2022 | Ankesa të shqyrtuara gjatë vitit 2022 | Mbartur për shqyrtim për vitin 2023 |
|--|---------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>1606</b>                            | <b>534</b>                            | <b>1072</b>                         |

Sipas të dhënave të ecurisë së shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, viti 2022 mbyllet me **1752<sup>3</sup>** ankesa në proces, të cilat do të mbarten për trajtim në vitin 2023. Në proces verifikimi janë **192**

<sup>2</sup> prej të cilave 534, janë pjesë e fondit backlog.

<sup>3</sup> 1072 prej tyre janë pjesë e fondit backlog.

ankesa, për të cilat nuk ka përfunduar shqyrtimi dhe përlogaritja e tyre nuk është përfshirë tek numri total i ankesave të shqyrtuara.

Rezultati i shqyrtimit të **1715** ankesave është:

- **1220** ankesa të arkivuara pas shqyrtimit fillestar<sup>4</sup>;
- **425** ankesa të arkivuara pas verifikimit<sup>5</sup>;
- **70** ankesa të përfunduara me hetim disiplinor<sup>6</sup>.

Nga **1715** ankesa të shqyrtuara rezulton se:

- **1502** ankesa janë depozituar nga persona fizikë;
- **212** ankesa janë depozituar nga persona juridikë, përkatësisht:
  - **133** ankesa nga institucione publike;
  - **62** ankesa nga subjekte private;
  - **16** ankesa nga fondacione dhe organizata të shoqërisë civile;
  - **1** ankesë nga media.
- **1** ankesë anonime, pasi nuk evidentohet emri i ankuesit.

### *3.1.1. Të dhënat për ankuesit*

Ankuesit të cilët i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë një përfaqësim gjeografik nga i gjithë vendi, ku peshën më të madhe e ka Qarku i Tiranës me 494 ankues (39.3% të ankuesve), ndjekur nga Qarku Durrës dhe Qarku Vlorë, respektivisht me 108 ankues (8.6%) dhe 99 ankues (7.9%). Ndërsa qarqet të cilat shënojnë numrin më të ulët të ankuesve janë, Qarku Dibër, Qarku Berat dhe Qarku Kukës, respektivisht me 30 (2.4%), 18 (1.5%) dhe 8 ankues (0.7%).

Gjatë vitit 2022 sërish vihet re se ka patur ankues të cilët kanë vendbanimin e tyre jashtë vendit, duke numëruar 8 ankues (0.7%), ndërsa 23 ankues (1.9%) kanë depozituar ankesat e tyre nëpërmjet postës elektronike, ndërsa 62 ankues (5%) nuk kanë evidentuar vendbanimin e tyre.

Nga analiza e informacionit lidhur me regjistrimin dhe trajtimin e ankesave, vihet re se 997 ankues (80%) kanë depozituar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vetëm 1 ankesë, ndërsa 260 ankues (20%) kanë depozituar më shumë se një ankesë, për të njëjtin subjekt të hetimit disiplinor.

### *3.1.2. Të dhëna për subjektin*

<sup>4</sup> prej të cilave 279, janë pjesë e fondit të backlog.

<sup>5</sup> prej të cilave 232 janë pjesë e fondit backlog.

<sup>6</sup> prej të cilave 23, janë pjesë e fondit backlog.

Ankuesit në total kanë ngritur pretendime ndaj 1684 subjekteve të hetimit disiplinor. Nga 1684 subjekte të hetimit disiplinor<sup>7</sup>, rezulton se pretendimet janë për 1129 gjyqtarë (67%), 243 prokurorë (14%) dhe për 312 (19%) gjyqtarë dhe prokurorë së bashku. Për 115 ankesa nuk identifikohet subjekti ndaj të cilit ngrihen pretendime.

Nga informacioni statistikor i ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2022, vihet re se pretendimet ndaj magjistratëve gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë numrin më të lartë të ankesave në raport me gjykatat e tjera të shkallës së parë por edhe të gjykatave të niveleve të tjera, me 218 ankesa. Kjo edhe për faktin se kjo gjykatë ka një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe gjithashtu shqyrton një numër të madh çështjesh. Më pas renditen gjyqtarët e Gjykatës Administrative Tiranë dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me nga 74 ankesa secila dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Vlorë kanë respektivisht 57 dhe 47 ankesa, ndërsa me 43 ankesa renditen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë. Me 15 ankesa renditen gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ndërsa gjykatat me më pak ankesa ndaj magjistratëve të tyre janë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me 0 ankesa, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tepelenë me 1 ankesë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me 2 ankesa dhe Gjykata Administrative Korçë me 3 ankesa.

Sa i takon ankesave të shqyrtuara, pretendime ndaj magjistratëve prokurorë, rezulton se ndaj prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë numërohen 118 ankesa, duke shënuar gjithashtu numrin më të madh të ankesave të ardhura krahasuar me zyrat e prokurorive të tjera. Më pas renditen prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, Korçë, Elbasan, Durrës, respektivisht me 28, 27, 23 dhe 14 ankesa. Për prokurorët e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) numërohen 16 ankesa. Ndërsa me numrin më të ulët të ankesave janë prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë vetëm me 1 ankesë, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë me 2 ankesa, dhe prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe Përmet me nga 3 ankesa secila.

### **3.2. Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, sipas kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të paragrafit 1, të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016. Gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikohet plotësimi i kriterëve të pranueshmërisë dhe brenda tre muajve nga depozitimi i ankesës vendoset për arkivimin e saj, nëse një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nuk

<sup>7</sup> Vlen të theksohet se një ankues ka ngritur pretendime, për më shumë se një subjekt të hetimit disiplinor, ndaj dhe numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve është më i lartë se numri i magjistratëve.

përmbushen. Sipas nenit 122 të ligjit nr. 96/2016, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit, duke kërkuar nga ankuesi dokumente dhe shpjegime shtesë për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar apo duke marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Në përmbushje të këtyre parashikimeve ligjore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar **1715** ankesa, për të cilat ka miratuar **1234** vendime:

- **862** vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të **1220** ankesave;
- **344** vendime për arkivimin pas verifikimit të **425** ankesave;
- **28** vendime për hetim disiplinor pas shqyrtimit të **70** ankesave.

Nisur nga shqyrtimi i objektit të ankesave, rezulton se problematikat apo pretendimet e ngritura më së shumti nga ankuesit ndahen si më poshtë:

- Ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve;
- Pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve;
- Shkelje procedurale nga ana e magjistratëve.

Nga analizimi i fakteve, ligjit dhe arsytimit të dhënë në vendim, ka rezultuar se shkaqet kryesore për arkivimin e ankesave të depozituara janë:

- Shkelja e pretenduar nuk parashikohej si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi<sup>8</sup>;
- Në kohën e shqyrtimit të ankesës, magjistrati nuk ushtronte funksionin e tij<sup>9</sup>;

Gjithashtu, konstatohet se ka arkivim të ankesave edhe për shkak të parashkrimit të shkeljes. Duke qenë se kemi një numër të rritur të ankesave të trajtuara nga fondi backlog, një pjesë e tyre janë parashkruar përpara se ato të regjistrohen pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Referuar numri të ankesave për llojin e procesit gjyqësor/objektit të padisë së shqyrtuar nga ana e magjistratit ndaj të cilit ngrihen pretendime në ankesë kemi këto të dhëna:

Tabela nr. 3 Numri i ankesave sipas llojit të çështjeve

| Lloji i çështjeve      | Numri i ankesave sipas llojit të çështjes |
|------------------------|---|
| Çështje Civile         | 652                                       |
| Çështje Penale         | 414                                       |
| Çështje Administrative | 63  |

<sup>8</sup> Neni 120, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

<sup>9</sup> Neni 120, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016. Këto janë rastet kur magjistrati i ka mbaruar statusin, për shkaqet e përmendura në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 apo kur magjistrati është shkarkuar nga KPA me vendim përfundimtar.

Nga vrojtimi i dukurisë së paraqitjes së ankesave, numri total i ankesave edhe pse nga viti në vit ka shënuar rënie të lehtë, vijon të mbetet i lartë. Ky tregues është matur rregullisht, mbi bazë të grumbullimit të informacionit statistikor, nga analizimi i të cilit, vëmë re se për vitin 2022 ka:

- Numër të lartë të ankesave që nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë;
- Rritje të lehtë të numrit të ankesave të paraqitura nga organet publike;
- Rënie të numri të ankesave të ardhura nga persona fizikë.

Për sa i takon faktit se gjatë vitit 2022 për të tretin vit të funksionimit të ILD-së, numri i ankesave të qytetarëve, në shqyrtim mbetet i lartë, faktor kontribuues vijon të mbetet backlog-u i trashëguar, por gjithashtu është edhe tregues i pritshmërisë së lartë të publikut ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Duke vlerësuar të dhënat statistikore për numrin e lartë të ankesave që arkivohen dhe kryesisht ato që arkivohen për shkak se nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë, janë ndërmarrë masa për ndërgjegjësim, të cilat do të vijojnë edhe gjatë vitit 2023.

Megjithëse numri i ankesave mbetet i lartë gjatë vitit 2022, vërehet një ulje e lehtë krahasuar me numrin e ankesave të ardhura në vitet paraardhëse. Efekt në rënien e numrit të ankesave të ardhura në krahasim me vitin 2021, ka patur edhe transparenca dhe ndërgjegjësimi i publikut, jo vetëm si një rekomandim i rezolutës së Kuvendit për raportin e veprimtarisë së viti 2021, por si mjeti kryesor në përhapjen e informacionit dhe qartësimin të rolit dhe objektit të punës së ILD-së për publikun e gjerë.

Në këtë drejtim, rezultatet e shqyrtimit të ankesave janë analizuar në mënyrë të detajuar dhe mbi bazën e tyre janë ndërmarrë disa masa që kanë për qëllim, rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin e publikut, me fokus të veçantë:

- publikimi i rezultateve të veprimtarisë në kohë reale në faqen zyrtare;
- hartimi i anketës për marrjen e mendimeve të qytetarëve për rolin dhe funksionet e ILD-së;
- hartimi i një programi të posaçëm për informimin dhe komunikimin publik;
- dalje publike në media kombëtare dhe lokale;
- publikimi në rrjetet e mediave sociale të aktiviteteve të ILD-së;
- lidhja e memorandumeve me disa nga fakultetet e drejtësisë në vend;
- takimet zyrtare të zhvilluara dhe aktivitetet e realizuara;
- përditësim të informacionit të thjeshtuar për publikun;
- pritje e përditshme me qytetarët për dhënie informacioni apo sqarime të nevojshme për ankesat dhe rolin e ILD-së;
- publikim dhe përditësim të të dhënave të regjistrit të kërkesave për informacion;
- të dhëna statistikore dhe raporte të ndryshme.

Analiza periodike të informacionit statistikor do të vijojnë edhe gjatë vitit pasardhës dhe masa të vazhdueshme ndërgjegjësimiti do të ndërmerren, për të sensibilizuar qytetarët se ankimi ndaj një magjistrati ndjek rregullat ligjore duke respektuar pavarësinë dhe paanësinë e në të njëjtën kohë duke i shërbyer interesit publik, në respektim të plotë të shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike. Ndërmarrja e këtyre masave, pritet të ketë ndikim dhe të japë rezultate në ndërgjegjësimin e opinionit publik, se roli i ILD-së është të vendosë ekuilibra të drejtë dhe të paanshëm, ndërmjet pretendimeve për cenim të interesave individuale të qytetarëve nga veprimtaria e magjistratëve dhe garantimit të pavarësisë dhe paanësisë së magjistratëve.

### 3.3. Hetimet Disiplinore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të neneve 123, pika 1 dhe 124, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Referuar këtyre parashikimeve ligjore, gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë pasi konstatoi ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme, ka miratuar 28 vendime për hetimin disiplinor, me anë të të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së 41 magjistratëve. Hetimi disiplinor për 3 subjekte ka filluar me iniciativë, për 38 subjekte mbi bazë ankese.

Rezultatet e hetimit janë si vijon:

- për 6 magjistratë<sup>10</sup> (3 gjyqtarë dhe 3 prokurorë) janë paraqitur pranë këshillave respektive kërkesat për procedim;
- për 1 magjistrat (1 gjyqtar) është pezulluar hetimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për procesin e rivlerësimit;
- për 22 magjistratë (20 gjyqtarë dhe 2 prokurorë) është mbyllur hetimi disiplinor për shkak të:
  - i) mbarimit të statusit të magjistratit;
  - ii) vlerësimit të fakteve, rrethanave të hetuara dhe provave të marra, si të pamjaftueshme për të provuar shkeljet e pretenduara.
- për 14 magjistratë (13 gjyqtarë dhe 1 prokuror) të hetimit disiplinor, procedurat hetimore janë në proces.

Për 8 subjektet të hetimit disiplinor, hetimi ndaj të cilëve ka filluar në vitin 2021, hetimet kanë vijuar edhe gjatë vitit 2022, konkretisht:

- për 2 magjistratë është pezulluar hetimi;

<sup>10</sup> Për 2 prej të cilëve hetimi ka nisur nga viti 2021 dhe kërkesa për procedim është përcjellë në vitin 2022.



- për 3 magjistratë dhe 3 subjekte të tjerë, është mbyllur hetimit.

Hetimi disiplinor për 41 subjekte të hetimit disiplinor ka filluar pas dyshimeve të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer. Shkeljet disiplinore për të cilat Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor, lidhen me shkelje disiplinore në ushtrimin e funksionit, të cilat renditen:

- vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale, të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016;
- mosparaqitje të kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla; të parashikuara në nenin 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar;
- për veprim, mosveprim ose sjellje të magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin, të parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronja “dh” të 96/2016;
- shkelje të tjera<sup>11</sup>.

Referuar të dhënave të hetimeve, krahasimisht me një vit më parë, numri i hetimeve dhe numri i magjistratëve të hetuar rezulton të jetë i rritur. Kjo jo vetëm falë rritjes profesionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe vendosjes së standardeve për vijimin e punës me produktivitet, por edhe krijimit të një ekuilibri të drejtë ndërmjet realizimit të një hetimi disiplinor të besueshëm në raport me shkeljet disiplinore të kryera dhe garancive të siguruara për një hetim disiplinor, sipas një procesi të rregullt ligjor

Tregues i qenësishëm për standardet e vendosura ka qenë pranimi i kërkesave për procedim në Këshilla<sup>12</sup>, por edhe lënia në fuqi e masave disiplinore nga KPA-ja<sup>13</sup>, si dëshmi e certifikimit të standardeve të ndjekura nga ILD-ja. Tregues tjetër i rëndësishëm është edhe numri i ulët i ankimeve për vendimet e mbylljes së hetimit disiplinor (më shumë shih në fq.18).

Hetimi disiplinor nuk ka për qëllim në vetvete procedimin disiplinor të sa më shumë magjistratëve, por vlerësimin e drejtë, të paanshëm dhe objektiv të të gjitha pretendimeve, dokumenteve mbështetëse për të gjykuar mbi veprimet a mosveprimet apo sjelljen e magjistratit ndaj të cilit ka një ankesë, denoncim publik a të dhëna nga organe shtetërore. Shpesh, publikisht në media, rrjetet

<sup>11</sup> të parashikuara nga:

neni 102, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

neni 102, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

neni 102, pika 1, shkronja “e” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

neni 102, pika 2, shkronja “c” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

neni 104 i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

neni 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

neni 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>12</sup> Këshillat në të gjitha rastet e paraqitura nga ILD kanë pranuar të gjitha gjetjet për shkeljet disiplinore të konstatuara në raportet hetimore.

<sup>13</sup> KPA ka lënë në fuqi kërkesat për procedim disiplinor të kërkuara nga ILD dhe masat e vendosura nga Këshillat.

sociale, nëpër studio e emisione televizive, apo edhe jopublikisht, përmes ankesave/informacioneve me shkrim pretendohen një tërësi faktesh të ndodhura, por Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve, që lidhen me këto të dhëna apo informacione në raport me shkelje disiplinore, të cilat mund të jenë kryer nga ana e magistratëve. Vetëm pas këtyre verifikimeve dhe kur ka shkaqe që e justifikojnë, bëhet fillimi i hetimit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në respektim të plotë të parimeve të procedimit disiplinor, ku ndër të tjera edhe parimit të procesit të rregullt ligjor, pasi ka hetuar rastet dhe nga analizimi i fakteve dhe kuadrit ligjor në fuqi, ka konstatuar se përfundimi i hetimeve ka ardhur si pasojë e:

- paraqitjes së kërkesës për procedim disiplinor;
- faktet dhe rrethanat e zbuluara gjatë hetimit nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor;
- mbarimit të statusit të magistratit, si një ndër kriteret ligjore për mbylljen e hetimit.

#### **3.4. Ankime kundër vendimeve të arkivimit dhe hetimit**

Bazuar në nenin 119, pika 4 dhe nenit 122, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankuesi ka të drejtën e ankimit në këshillin përkatës kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës. Neni 62, pika 13 dhe neni 160, pika 13 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikojnë respektivisht të drejtën për ankim ndaj vendimeve të arkivimit ose të pushimit/mbylljes së hetimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pranë Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankimeve, që ngrihen respektivisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vendimet e Komisionit të Përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit.

Gjatë vitit 2022 ILD ka marrë 1224 vendime objekt ankimi pranë Komisioneve të Përkohshme, nga ku rezulton se kundër vendimeve janë depozituar:

- 83 ankime ndaj 862 vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;
- 15 ankime ndaj 344 vendimeve të arkivimit pas verifikimit;
- 1 ankim ndaj 18 vendimeve për mbylljen e hetimit disiplinor.

Nga 1224 vendime janë ankimuar vetëm 98 vendime arkivimi, ose thënë në përqindje, janë ankimuar 8 % e vendimeve të arkivimit. Ndërsa për 18 vendime për mbyllje të hetimit disiplinor rezulton vetëm 1 vendim i ankimuar, ose 5.5% e vendimeve të hetimit të ankimuar. Nga të gjitha ankimet e paraqitura rezultojnë 0 vendime të kthyer për shqyrtim.

Tabela nr. 4 Numri i vendimeve të ankimuara

| Viti | Vendime arkivimi të ankimuara | Vendime për mbyllje hetimi të ankimuara | Total | Vendime të kthyer për shqyrtim nga Komisioni i Përkohshëm |
|------|-------------------------------|---|-------|---|
| 2022 | 98                            | 1                                       | 99    | 0   |

Sikurse evidentohet më sipër, për vitin 2022 rezulton të ketë sërish një numër të ulët të ankimeve, në Komisionet e Përkohshme pranë Këshillave, ndaj vendimeve të ILD-së. Për të gjitha ankimet kundër vendimeve të arkivimit, rezulton se për të gjitha rastet Komisionet kanë vendosur refuzimin si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesit ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e për pasojë asnjë prej vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk është kthyer për rishqyrtim.

Mjeti i ankimit në dispozicion të ankuesit dhe shqyrtimi i tyre nga komisionet përkatëse të parashikuara në ligj, japin sigurinë dhe garantojnë se vendimmarrja e ILD-së është objekt shqyrtimi i ligjshmërisë në mënyrë të vazhdueshme. Nga rezultatet e ankimeve të vitit 2021, por edhe nga viti 2022, rezulton se praktika e punës së ngritur dhe që ndiqet aktualisht nuk është cenuar nga organet kompetente për shqyrtimin e tyre.

### 3.5. Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas vlerësimit të provave të mbledhura dhe kur rezultatet e hetimit çojnë drejt përfundimit se ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, fillon procedimin disiplinor pranë Këshillave, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

Gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 6 magjistratë, për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor, bazuar në shkeljet disiplinore të parashikuara nga nenet 102-104 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për:

Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si:

- mospërbushje e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;
- vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve

- dhe/ose akteve procedurale;
- veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;
  - shkelje e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorive;
  - moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;
  - mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë.

Për 3 kërkesat për procedim disiplinor të paraqitura në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar këto masa disiplinore:

- “Shkarkim nga detyra” - 1 rast;
- “Pezullim nga detyra” - 1 rast;
- “Vërejtje publike” - 1 rast.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve Këshilli i Lartë Gjyqësor:

- Për 1 rast “Shkarkim nga detyra” ka pranuar kërkesën pjesërisht duke vendosur për një masë të ndryshme disiplinore;
- Për 1 rast “Vërejtje publike” procedimi disiplinor është pezulluar;
- Për 1 rast “Pezullim nga detyra” është në proces.

Për 3 kërkesat për procedim disiplinor të paraqitura në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar këto masa disiplinore:

- “Shkarkim nga detyra” - 2 raste;
- “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit” - 1 rast.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

- Për 2 raste “Shkarkim nga detyra”, 1 rast është pezulluar dhe 1 rast është në proces;
- Për 1 rast “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, rasti është pezulluar.

Tabela nr. 5 Dinamika e masës disiplinore të propozuar nga ILD

| Masa disiplinore e propozuar nga ILD  | Numri i kërkesave për procedim disiplinor | Numri i magjistratëve të propozuar për masë disiplinore | Magjistrati |         |
|---|---|---|-------------|---------|
|   |   |   | Prokuror    | Gjyqtar |
| <b>Pezullim nga detyra</b>  | 1   | 1   | 0           | 1       |
| <b>Shkarkim nga detyra</b>  | 3   | 3   | 2           | 1       |
| <b>Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit</b> | 1   | 1   | 1           | 0       |
| <b>Vërejtje publike</b>   | 1   | 1   | 0           | 1       |
| <b>Totali</b>   | 6   | 6   | 3           | 3       |

Procedimi disiplinor si momenti përmbyllës i veprimtarisë hetimore, paraqet rëndësi në drejtim të kontributit të ILD-së në një nga shtyllat e reformës në drejtësi, asaj të rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Procedimi disiplinor nuk ka si qëllim të vetëm ndëshkimin e magjistratëve apo largimin e tyre nga sistemi, por ka edhe qasje ndërgjegjësuese dhe edukuese për të frenuar fenomene që ndikojnë në drejtësi më të mirë dhe forcimin e besimit të publikut tek organet e reja të sistemit të drejtësisë.

Nga praktika e ndjekur deri më tani me Këshillat, në disa raste propozimet për masë disiplinore janë ndryshuar pjesërisht. Ndryshimet kanë patur të bëjnë me vlerësimin e Këshillave, për sa i takon llojit të masës së dhënë. Në asnjë rast nuk është cenuar ligjshmëria e hetimit, verifikimit të shkeljeve apo vetë ekzistenca e saj, por ndryshimi ka të bëjë me llojin e masës disiplinore të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në këtë rast, është konfirmuar ekzistenca e shkeljes disiplinore dhe është konfirmuar procedura hetimore e ndjekur, por Këshilli i Lartë i Prokurorisë në ushtrim të diskrecionit për gjykimin e shkeljeve dhe vlerësimin mbi masën disiplinore të propozuar, ka vendosur për një masë më pak të rëndë ose e ka referuar çështjen për vlerësim të brendshëm profesional të magjistratëve.

Marzhi i vlerësimit nga Këshillat, vjen i harmonizuar me bindjen e krijuar përmes gjykimit dhe shqyrtimit të provave e dokumentacionit për procesin hetimor të zhvilluar, me praktikën e ndjekur për raste të ushtrimit të diskrecionit, proporcionalitetin e shkeljes së kryer, por edhe nevojat e sistemit të drejtësisë apo faktorë të jashtëm me ndikim në sistem.

Në rastet kur Këshilli ka vendosur ndryshe nga propozimi i ILD-së për masën disiplinore, vendimet nuk kanë rrëzuar standardet e hetimit dhe procedimit disiplinor të propozuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por janë dëshmi e pranimit të tyre, që tashmë janë të konfirmuar edhe nga Kolegji i

Posaçëm i Apelimit të Gjykatës Kushtetuese.

### 3.6. Ecuria e trajtimit të ankesave *backlog*

Gjatë vitit 2022 për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë ka qenë prioritet ulja e numri të ankesave backlog. Sikurse është paraqitur në raportin e veprimtarisë së vitit 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë e mbylli vitin me 1606 ankesa backlog në proces. Në kuadër të këtyre masave administrative të ndërmarra gjatë vitit 2021 dhe ndjekja e tyre edhe përgjatë vitit 2022, rezulton se nga fondi i mbetur prej 1606 ankesa, janë trajtuar 534 ose 33 % e ankesave dhe mbeten për t'u trajtuar 1072 ankesa.

Tabela nr. 6 Ecuria e trajtimit të backlog 2020-2022

| Viti | Gjendje backlog | Trajtuar | Mbetur për t'u trajtuar |
|------|-----------------|----------|-------------------------|
| 2020 | 2104            | 65       | 2,039                   |
| 2021 | 2039            | 433      | 1606                    |
| 2022 | 1606            | 534      | 1072                    |
| 2023 | 1072            | -        | -                       |

Tërësia e masave administrative dhe organizative që ka ndërmarrë Inspektori i Lartë i Drejtësisë për trajtimin e backlog-ut, kanë dhënë efekte të matshme. Krijimi i metodologjisë së trajtimit të ankesave të backlog, ka dhënë efektet e veta duke rritur numrin e ankesave të shqyrtuara dhe duke reduktuar stokun. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka caktuar tregues të brendshëm për të matur ecurinë e trajtimit. Treguesi i brendshëm është përlllogaritur mbi bazën e kapacitetit ekzistues të burimeve njerëzore. Kapaciteti i shqyrtimit të ankesave backlog është planifikuar të zinte 20%, të tyre çdo muaj, për 11 muaj, ose mesatarisht 42 ankesa në muaj. Vlera fillestare e përcaktuar për trajtim kishte në konsideratë faktin se gjatë vitit 2021, kapacitetet e Njesisë së Inspektorëve do të ishin plotësuar dhe ky tregues do të ishte arritur deri në vitin 2022. Pavarësisht se gjatë vitit 2022, nuk ka patur asnjë komandim për magjistrat, ky objektivi është arritur duke tejkaluar pritshmërinë prej 42 ankesave në muaj, duke e rritur me 101 ankesa më shumë të shqyrtuara për vitin 2022, por pavarësisht efektit pozitiv, nuk është arritur objektivi kryesor, ai i përfundimit të shqyrtimit i të gjithë fondit të backlog-ut. Në adresimin e kësaj problematike janë ndërmarrë masa të plotësimit të vendeve vakante për inspektorë jomagjistratë. Plotësimi i vendeve vakante përmes procedurave konkurruese për rekrutimin e inspektorëve jomagjistratë të përfunduar nga ILD-ja në fund të tetorit të vitit 2022, si dhe me fuqizimin i kapaciteteve të inspektorëve, fondi backlog pritet të përfundohet tërësisht, pasi po punohet me kapacitet të plotë sipas metodologjisë të paracaktuar për përfundimin e backlog-ut, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023.

### 3.7. Inspektimet tematike

Në mbështetje të nenit 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në objektin e veprimtarisë së tij, ndër të tjera kryen edhe inspektime institucionale dhe tematike, në lidhje me çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorive.

Gjatë vitit 2022 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përfunduar 2 inspektime tematike të iniciuara gjatë vitit 2021, konkretisht:

1. *Mbi respektimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Objektivat që synohen të arrihen përmes inspektimit tematik janë:

- Njohja dhe konstatimi i efektivitetit të veprimtarisë së prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore subjekt inspektimi;
- Dhënien e rekomandimeve të karakterit legjislativ, administrativ, organizativ apo funksional lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit me karakter personal;
  - Identifikimin e veprimeve/mosveprimeve apo sjelljeve të magjistratëve, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Inspektimi tematik paraqet rëndësi në:

- Rritjen e standardeve në veprimtarinë e magjistratëve në zbatimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit me karakter personal, të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, Kushtetutë dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 278 të Kodit Penal në veçanti.

Inspektimi tematik u përqendrua kryesisht në tre drejtime kryesore:

- (i) Proporcionalitetin e masave të propozuara;
- (ii) Veprimet procedurale të kryera nga ana e prokurorit për të identifikuar dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova;
- (iii) Niveli i arsytimit të bërë nga ana e prokurorit për t’i siguruar gjykatës se ekzistojnë së bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit me karakter personal.

Nga analizimi i të dhënave gjatë periudhës së inspektimit është konkluduar se:

- Masat e sigurimit personal të kërkuara nga ana e prokurorit në zyrat e prokurorive subjekte të inspektimit, kanë qenë në përgjithësi proporcionale në raport me shkallën e nevojave të sigurimit për rastet konkrete, rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i K. Penal dhe me rrethanat që lidhen me autorin e dyshuar, deri në fazën e kërkuar.
- Qëndrimi i prokurorëve për llojin e masës së sigurimit që kërkohet është i njëjtë referuar rrethanave të faktit penal.
- Janë konstatuar raste të aplikimit të masës së sigurimit “garanci pasurore” në të cilat janë vërejtur problematika në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të dispozitës procedurale, neni 236 i Kodit të Procedurës Penale.
- Gjatë shqyrtimit të kërkesave për zëvendësim mase apo revokim mase sigurimi, janë konstatuar qëndrime të prokurorit në interpretim të gabuar të dispozitave që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale, në drejtim të ndryshimit të kualifikimit të faktit penal e cila konsiderohet si një nga argumentet mbi të cilat mund të bëhet një vlerësim ndryshe i proporcionalitetit të masës së sigurimit të vendosur.
- Gjatë trajtimit të çështjeve me objekt caktim i masave të sigurimit me afat, në zyrat e prokurorive janë vërejtur interpretime jo të bazuara në kuptimin e nenit 245/1/d të Kodit të Procedurës Penale për dhënien e një mase sigurimi me afat. Në rastet kur janë vënë re zbatime të gabuara të dispozitës për përcaktimin e afatit, këto masa janë caktuar nga vetë gjykata, ndërkohë që nga ana e prokurorit është propozuar e njëjta masë sigurimi pa afat. Qëndrime të tilla si të prokurorit dhe të gjykatës, në përfundim të afatit të masës së sigurimit kanë passjellë situata procedurale në të cilat janë shfaqur interpretime të gabuara si në drejtim të formës së aktit procedural, ashtu edhe në drejtim të zgjidhjes së thelbit të çështjes lidhur me caktimin/zëvendësimin apo revokimin e masës së sigurimit.
- Në rastet e dhënies së vendimit nga ana e gjykatës ndryshe nga kërkesa e prokurorit, është konstatuar mosushtrim i të drejtës së ankimit nga ana e këtij të fundit dhe nga ana formale e cila parashikohet në nenin 408 të Kodit të Procedurës Penale.
- Konstatohet se ka praktika të ndryshme ndërmjet zyrave të prokurorisë subjekte inspektimi mbi mënyrën e të proceduarit për njoftimin e gjykatës, në kuadër të zbatimit të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale në rastet e zbatimit të një mase sigurimi të caktuar në mungesë nga ana e gjykatës.
- Konstatohet se pavarësisht se gjejmë një analizë të mirë tek vendimet gjyqësore nga ana e gjykatës, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për sa i përket arsyetimeve të prokurorëve në lidhje me caktimin e masave të sigurimit në mënyrën e paraqitjes së kushteve dhe kriterëve.
- Në të gjitha prokuroritë subjekte të këtij inspektimi vihet re se në veprimet procedurale të kryera nga ana e tyre mungon paraqitja e një formati të unifikuar në lidhje me paraqitjen e këtyre të fundit.

Grupi i inspektimit i është drejtuar organeve subjekte të këtij inspektimi me disa rekomandime me qëllim njohjen me praktikat më të mira të identifikuara dhe problematikat e konstatuara në



respektimin e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masave shtrënguese, si dhe të tjera në zbatimin e ligjit. Këto rekomandime kanë synim ndërmarrjen e veprimeve të koordinuara përmes masave legislative, organizative, administrative dhe rritje kapacitetesh profesionale për të ndjekur trajnime si vijon:

- Prokurori duhet të përfshijë në analizën e mësipërme edhe dispozitat konkrete të Kodit të Drejtësisë për të Mitur;
- Me rastin e kërkesave për zëvendësim/revokim mase sigurimi, prokurori duhet të jetë me një qëndrim konkret dhe jo evaziv përkundrejt masës së sigurimit që duhet t'i caktohet personit nën hetim.
- Në kuadrin e kompetencave administrative dhe arsytimit lidhur me veprimtarinë e të proceduarit të prokurorit, në këto raste, referuar zbatimit të nenit 256 dhe nenit 258 të Kodit të Procedurës Penale duhet të mbahet në vëmendje një unifikim i hartimit të një procesverbali për të gjitha zyrat e prokurorive të rretheve.
- Për sa i përket gjykatave, në kuadër të rritjes së cilësisë së vendimmarrjeve duhet të rritet në mënyrë cilësore respektimi i afateve të parashikuara në nenet përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.
- Në mënyrë që të sigurohet një zbatim dhe interpretim i saktë i dispozitave ligjore në mënyrë që të mos hasen problematika në zbatimin e tyre sugjerohet që të bëhen pjesë e kurrikulave të trajnimit vazhdues të prokurorëve dhe gjyqtarëve, trajnimet pranë Shkollës së Magjistraturës, ku përfshihen çështjet e interpretimit dhe zbatimit në praktikë të nenit 236 të Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Drejtësisë për të Mitur, çështjet e interpretimit ligjor mbi kushtet lidhur me caktimin e masës së sigurimit dhe ato lidhur me teknikën e shkrimit dhe të hartimit të kërkesave nga ana e prokurorëve dhe të vendimeve nga ana e gjyqtarëve, që lidhen me masat e sigurimit.
- Për sa i përket Këshillave, rekomandohet një kujdes i shtuar në drejtim të cilësisë së hartimit të vendimmarrjeve për masat e sigurimit.

2. *“Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar.”*

Objektivat që synohen të arrihen përmes këtij inspektimi tematik janë:

- Evidentimi i problematikave të mundshme në raport me zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe propozime të mundshme në drejtim të rregullimit të marrëdhënieve mes prokurorëve, drejtuesve të Prokurorive dhe Prokurorit të Përgjithshëm, organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, të unifikimit të praktikave, të trajnimit vazhdues e ndryshimeve ligjore.

- Dhënia e rekomandimeve të karakterit legjislativ, administrativ, organizativ apo funksional lidhur me rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve, drejtuesve të prokurorive dhe Prokurorit të Përgjithshëm në kuadër të informimit, transparencës dhe garantimit të pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.
- Identifikimi i veprimeve/mosveprimeve apo sjelljeve të magjistratëve, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Inspektimi tematik paraqet rëndësi në:

Kritjen e standardeve në veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm për unifikimin e të drejtave dhe detyrimeve të prokurorit në marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorive, e këtyre të fundit me Prokurorin e Përgjithshëm, informimin dhe koordinimin e veprimtarisë së prokurorisë për të siguruar pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve të tij, si dhe mbikëqyrjen, ligjshmërinë e transparencën në prokurori.

Inspektimi tematik u përqendrua kryesisht në tre drejtime kryesore:

- (i) Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme detyruese nga ana e prokurorit më të lartë dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;
- (ii) Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme nga ana e drejtuesit të prokurorisë për prokurorët dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;
- (iii) Mënyra e informimit të drejtuesve në prokurori nga prokurori, si dhe informimi dhe raportimi i drejtuesit të prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm.

Nga analizimi i të dhënave gjatë periudhës së inspektimit është konkluduar se:

- Nga të dhënat e marra, për periudhën e inspektimit, nuk rezulton ndonjë rast që nga ana e drejtuesit të prokurorisë si prokurori më i lartë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave sipas nenit 5, pika 5 të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12, datë 20.07.2020, i ndryshuar, të jetë kërkuar fillimi i verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme, ndaj prokurorit lidhur me zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme.
- Është konstatuar se në asnjë prej udhëzimeve të përgjithshme, në pjesën e dispozitivit, nuk është pasqyruar e drejta e ankimit si pjesë e anës formale të aktit.
- Në udhëzimet e përgjithshme të nxjerra nga disa drejtues të prokurorive janë evidentuar disa parashikime që duket se nuk janë në përputhje të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Gjatë periudhës së inspektimit vërehet se kompetenca për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme mbetet në nivele mesatarisht të ulëta.

- Nga drejtuesit e prokurorive evidentohet kuptim dhe zbatim jo në harmoni me parashikimet e nenit 48, pika 3 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, sa i takon nxjerrjes kryesisht të udhëzimeve jo të detyrueshme, të cilat duhet të jepen në momentin e referimit të veprës penale ose regjistrimit të kallëzimit penal dhe caktimit me short të prokurorit përkatës.
- Evidentohet se udhëzimet jo të detyrueshme apo udhëzimet e përgjithshme të nxjerra nga zyrat e prokurorive objekt inspektimi, nuk kanë një unifikim në drejtim të formatit që ndjekin.
- Në periudhën e marrë në inspektim nuk u konstatua ndonjë rast i informimit për çështje konkrete për të cilat mund të dilet dhe me ndonjë udhëzim në marrëdhënien në nivele prokuror dhe drejtues prokurorie pa kërkesë të këtij të fundit.
- Evidentohet fakti, se edhe pse janë miratuar një sërë aktesh procedurale me karakter të përgjithshëm me qëllim marrjen e masave, nuk ka patur të dhëna për raportim periodik tek Prokurori i Përgjithshëm.
- Në Prokurorinë e Përgjithshme për periudhën 6-mujore të inspektimit nuk evidentohen të dhëna për ndonjë rast që prokurorët e kësaj prokurorie informojnë Prokurorin e Përgjithshëm për çështjet që përfaqësojnë në Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën Kushtetuese dhe si bëhet ky informim, siç është parashikuar në nenin 19 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.

Në përfundim të inspektimit janë hartuar disa rekomandime edhe për prokuroritë përkatëse objekt inspektimi pranë Shkallës së Parë dhe atyre të Apelit, të cilat konkludojnë në:

- Përditësimi nga ana e prokurorive në mënyrë koherente me ndryshimet e bëra me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Rishikimi i urdhrave të nxjerra nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe harmonizimi për sa i përket një numri të dispozitave të udhëzimeve të përgjithshme të drejtuesve, referuar ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Kodit të Procedurës Penale.
- Rekomandohet që udhëzimet jo të detyrueshme të jepen të strukturuar në anën formale dhe t’i përgjigjen qëllimit të këtij lloji udhëzimi, kryesisht nga drejtuesi.
- Të ndërmerren masa nga drejtuesit e prokurorive për të informuar Prokurorin e Përgjithshëm, në mënyrë periodike lidhur me gjendjen e kriminalitetit, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja “I” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Rekomandohet njohja e të gjithë prokurorëve të prokurorive të përfshira në inspektim me problematikat lidhur me mosdhënien e informacionit drejtuesit të prokurorisë dhe pasqyrimin e të dhënave.
- Unifikimi i një praktike në mënyrën e informimit me shkrim nga drejtuesi i prokurorive tek Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet nxjerrjes së një udhëzimi të përgjithshëm në

funksion të mbarëvajtjes, efencës, ligjshmërisë dhe transparencës, në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur.

- Sugjerohet për Prokurorinë e Përgjithshme që të rishikojë modelin e regjistrimit të komunikimeve të brendshme.
- Rekomandohet të forcohet koordinimi dhe monitorimi i ecurisë së zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Rekomandohet vijimi i bashkëpunimit të drejtuesve të prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit statistikor, të analizës dhe digjitalizimit të informacionit e regjistrave në prokurori, si dhe rritjen e kontributit të prokurorisë në hartimin e statistikave të njësuara në fushën e drejtësisë, që të shërbejnë si bazë për të analizuar kriminalitetin, politikën penale të zbatuar dhe efektivitetin e saj.
- Rekomandohet marrja e masave për rritjen profesionale, si dhe vijimin e trajnimeve të prokurorëve me tema në kuadrin e ri ligjor të funksionimit të prokurorisë dhe të disa elementeve bazë si, përgjegjshmëria, profesionalizmi, integriteti dhe besueshmëria për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së prokurorit.

### 3. “Lirimi me kusht”

Ky inspektim, si një nga inspektimet më sfiduese, për shkak të volumit të lartë të praktikave dokumentare të shqyrtuara, numrit të lartë të gjykatave dhe prokurorive të përfshira në objektin e inspektimit, si dhe mungesës së 25 inspektorëve në kohën e nisjes së tij dhe fluksit të backlog-ut por edhe të ankesave të paraqitura drejtpërdrejt në ILD, kanë ndikuar ndjeshëm në shtrirjen kohore të realizimit dhe për pasojë mbylljen dhe adresimin e rekomandimeve përkatëse.

Pavarësisht shtrirjes në kohë, rezultatet e këtij inspektimit kanë qenë të menjëhershme, pasi gjatë zhvillimit të tij ILD ka paraqitur 2 kërkesa për procedim disiplinor në vitin 2020 dhe 1 kërkesë për procedim disiplinor gjatë vitit 2021. Ky inspektim pritet të përfundojë brenda vitit 2023 dhe do të konkludohet në një raport ku do të përfshihen konkluzionet e dala gjatë këtij procesi dhe në rekomandimet përkatëse për institucionet e gjykatave dhe prokurorive.

Ky inspektim tematik është iniciuar nga ILD, që me marrjen e detyrës për shkak të ndjeshmërisë së lartë publike në atë kohë, për lirimin nga qelitë të atyre, që në gjuhën e përditshme etiketohen si “të fortët”. Ky inspektim ka prodhuar efekte sepse janë disa magjistratë të shkarkuar edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, shkarkime të cilat janë konfirmuar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, duke konfirmuar kështu standardin e punës së Zyrës së ILD-së. Përveç këtij rezultati në drejtim të identifikimit të përgjegjësive individuale të magjistratëve, ka patur një efekt të konstatuar në drejtim të përdorimit më të kujdesshëm të institutit të “lirimit me kusht” dhe rritje të cilësisë së vendimmarrjes. Rezultat po aq i dukshëm i këtij inspektimi është fakti se nuk ka asnjë ankesë të paraqitur për shkelje që lidhen me zbatimin e këtij instituti, e në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2022 nuk ka as denoncime publike për raste problematike të lirimit kusht.

Lidhur me dy inspektimet e përfunduara, rezultatet e efekteve në sistem do të evidentohen nga matja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi. Këto rezultate do të jenë pjesë e raportit të punës për vitin 2023.

Në funksion të përmirësimit të inspektimit është miratuar metodologjia e inspektimit, e cila është dokument unifikues i praktikës së punës dhe një udhëzues praktik për inspektorët, në funksion të realizimit të inspektimit. Metodologjia është konceptuar në vlerësim të praktikave të vendeve anëtare të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit RESIJ. Nisur nga statusi aktual i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si anëtar vëzhgues në RESIJ, i cili njihet me praktikat më të mira nga institucionet homologe, gjatë hartimit të kësaj metodologjie janë marrë në studim praktika inspektimi të ngjashme nga Inspektorati i Lartë i Ministrisë së Drejtësisë në Itali, Inspektorati Spanjoll, Shërbimet e Inspektimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në Portugali, Rumani e Bullgari. Metodatat e ndjekura për kryerjen e një inspektimi, përkohë me ato metoda që ofron praktika e vendeve anëtare të RESIJ, që janë kryesisht ato të këqyrjes së veprimtarisë, marrjes dhe analizimit të dokumenteve dhe dosjeve, analizim të informacionit statistikor e çdo të dhënë tjetër të dobishme dhe kryerjes së vizitave nga afër në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë së organit të inspektuar.

Edhe për vitin 2022, është vijuar me rritje kapacitetesh për Njësinë e Inspektorëve ku janë realizuar vizita studimore në disa vende të RESIJ, për të marrë eksperiencat dhe përvojat më të mira në fushën e inspektimeve. Në dhjetor të vitit 2022 është realizuar një vizitë pune pranë Inspektoratit të Lartë të Ministrisë së Drejtësisë në Itali, ku disa inspektorë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë marrë pjesë si vëzhgues në një procedurë inspektimi pranë Gjykatës së Apelit, Romë. Përvoja praktike e zhvillimit të një inspektimi dhe këqyrja nga afër e procesit, janë eksperiencat unike me një vlerë të shtuar për rritjen e kapaciteteve për Njësinë e Inspektorëve dhe vizita të tilla priten të ndërmerren në vazhdim.

#### **IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR**

##### **4.1. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë/KPK**

Bashkëpunimi dhe forcimi i marrëdhënieve institucionale me organet e sistemit të drejtësisë, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë ka qenë dhe do të mbetet një aspekt shumë i rëndësishëm.

Sa i takon bashkëpunimit me Këshillat, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në çdo rast ka trajtuar me prioritet maksimal dhënien e informacionit lidhur me ankesat e depozituara, për magjistratët që aplikojnë për ngritje në detyrë, brenda sistemit të karrierës. Bashkëpunimi ka vijuar edhe në drejtim të të dhënave të kërkuara për verifikimin e ankesave për magjistratë të ndryshëm, rezultatet e të cilave u janë vënë në dispozicion në kohën e duhur.

Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka administruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të dhëna periodike të përditësuara për:

- Listat me emrat e magjistratëve të cilët ushtrojnë aktualisht detyrën.
- Listat e ish-magjistratëve të cilët nuk janë më pjesë e sistemit të drejtësisë.
- Shkëmbimi i informacioneve në kuadër të hetimit dhe vlerësimit të magjistratëve.

Komunikimi me KLGJ dhe KLP ka vijuar nëpërmjet personave të kontaktit për bashkërendimin e punës dhe shkëmbimin e informacionit të vazhdueshëm e në kohë.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi të nisur ndërinstitucional, me Komisionin e Pavarur të kualifikimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë administron informacion nga KPK-ja, për çdo vendimmarrje ndaj magjistratëve prokurorë apo gjyqtarë, në kuadër të procesit të rivlerësimit. Ky komunikim vijon për shkak të nevojave reciproke për informacion të përditësuar me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në trajtimin e ankesave ndaj magjistratëve që janë në detyrë. Çdo komunikim që lidhet me referimet e KPK-së për verifikim ndaj veprimtarisë së magjistratëve edhe pse të konfirmuar në detyrë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka shqyrtuar çdo rast të përcjellë, me prioritet të lartë, duke kryer verifikimet e nevojshme.

#### **4.2. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Prokurori i Përgjithshëm**

Bashkëpunimi me Prokurorin e Përgjithshëm, vijon në kuadër të angazhimeve të ndërsjella me nënshkrimin e memorandumit “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”. Për vitin 2022 nuk ka patur ankim me shkrim për shkelje disiplinore, por as kërkesa për inspektime institucionale apo tematike.

Në kuadër të bashkëpunimit për dy inspektimet e përfunduara, raportet e inspektimit i janë drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm duke përcjellë konkluzionet e efektivitetit të veprimtarisë së prokurorive objekt inspektimi dhe rritjen e standardeve në veprimtarinë e magjistratëve, në zbatimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit me karakter personal, të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, Kushtetutë dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për veprën penale të parashikuar nga neni 278 të Kodit Penal në veçanti. Rekomandimet përmbajnë masa të karakterit legjislativ, administrativ, organizativ apo funksional, lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit me karakter personal.

Gjithashtu me përfundimin e inspektimit të dytë, mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar, janë rekomanduar masa administrative, organizative apo funksionale, lidhur me rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve, drejtuesve të prokurorive

dhe Prokurorit të Përgjithshëm në kuadër të informimit, transparencës dhe garantimit të pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

### 4.3. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka vijuar me ofrimin e kontributeve, hartimin e raporteve dhe përcjelljen e informacioneve në ushtrim të kompetencave, sipas çështjeve të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale 2021-2025, planin e masave për zbatimin dhe monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Evropian, lidhur me Kriterin Politik dhe Kapitullin 23, të acquis të Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë gjatë vitit 2022, në kuadër të politikave shtetërore për sistemin e drejtësisë, është zhvilluar nëpërmjet një sërë raportimesh apo aktiviteteve të mbajtura në kuadër të këtyre raportimeve, konkretisht:

- “Procesi i Hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2022-2024”;
- “Raportim Indikator 2 (ILD) për kontratën me mbështetje buxhetore SBS 2019-2023”;
- “Rishikimi i indikatorëve të Kontratës Sektoriale”;
- “Draft plani i masave të rekomandimeve të raportit të KE të vitit 2021 për Shqipërinë”;
- “Kontributi i Qeverisë Shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian 2022 (për periudhën 1 qershor 2021-28 shkurt 2022) - LGA- IAGA”;
- “Raporti i monitorimit për vitin 2021 në zbatim të SND 2021-2025”;
- “Hartimi i Kontributit të dytë të Qeverisë Shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022”;
- “Monitorimi i masave zbatuese T2 2022 (Rekrutimet e inspektorëve jomagjistratë)”;
- “Mbi rishikimin e targetit të vendosur për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në Kontratën Sektoriale “BR për reformën në drejtësi””;
- “Treguesit e rezultatit për 6-mujorin e I-rë të 2022 sipas Pasaportës së Indikatorëve të Planit të Veprimit për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025”.

Në datat 24-25 nëntor të vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, e me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit të lartë të organeve të pavarura dhe të ekzekutivit, ishte pjesë e takimeve dy palëshe BE-Shqipëri. Autoriteteve shqiptare u është kërkuar të paraqesin shkallën e përafrimit me acquis dhe planet e ardhshme për përafrim. Takimi dy palësh BE-Shqipëri, u shoqërua me prezantime të përgatitura dhe të prezantuara për fushat si më poshtë:

- Pavarësia dhe paanshmëria;
- Eficenca e gjyqësorit.

Prezantimet kishin si qëllim informimin e Komisionit Evropian mbi nivelin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë të acquis të Bashkimit Evropian, sipas fushave të Kapitullit 23

“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Prezantimet përfshinin situatën ligjore ekzistuese, mekanizmat institucionale të vëna në dispozicion për garantimin e zbatimit të këtij legjislacioni, të dhëna statistikore, impakti që ka patur në një fushë të caktuar dhe planet për të ardhmen.

Pjesëmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë takim paraqiti rëndësi për procesin duke u përcjellë nga afër përfaqësuesve të Lartë të Bashkimit Evropian, zhvillimet e veprimtarisë institucionale, por edhe diskutim të rezultateve të sistemit të llogaridhënies së magjistratëve në Shqipëri, pas miratimit të reformës në drejtësi. Inspektori i Lartë evidentoi kuadrin rregullator të sistemit llogaridhënës të magjistratëve, ecurinë e këtij procesi llogaridhënës, duke paraqitur edhe problematikat, me të cilat institucionet e reja të drejtësisë dhe ILD specifikisht, u përballën në momentin e krijimit të tyre. Inspektori i Lartë i Drejtësisë theksoi se me gjithë vështirësitë, sistemi llogaridhënës i magjistratëve në Shqipëri po funksionon. Tregues i qartë është interesi i publikut në lidhje me përdorimin e sistemit të ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe përdorimi gjerësisht i mekanizmit kushtetues dhe ligjor të kontrollit të punës së magjistratëve. Funksionimi i sistemit llogaridhënës është një çështje thelbësore dhe me rëndësi të veçantë për të ardhmen, pasi një sistem së pari duhet të funksionojë dhe më pas të japë rezultate. Efektet e këtyre rezultateve janë të shtrira në kohë në mënyrë që sistemi llogaridhënës të funksionojë tërësisht, në përputhje me vlerat evropiane të respektimit të të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe shtetit të së drejtës si aset thelbësor i Bashkimit Evropian.

#### **4.4. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka ofruar bashkëpunim mbi bazë kërkesë, në kuadër të përmbushjes së politikave shtetërore në fushën e politikës së jashtme dhe atyre të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si dhe ka kontribuar në përcjelljen e informacioneve drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Bashkëpunimi me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka pasur në fokus monitorimin e zbatimit të parashikimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për Shqipërinë, në funksion të aktiviteteve dhe takimeve periodike të përbashkëta sipas Nënkomitetit: Bashkimi Evropian-Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.

Angazhimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë Nënkomitet ka qenë përmes paraqitjes së raportimeve periodike, si dhe nëpërmjet takimeve të grupit ndërinstitucional të punës. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ofruar bashkëpunim të plotë në kuadër të përmbushjes së politikave shtetërore në fushën e politikës së jashtme dhe atyre të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

#### **4.5. Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile**

Në muajin mars të vitit 2022 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit, ndërmjet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe disa prej organizatave të shoqërisë civile, të cilat janë të angazhuara në



monitorimin e veprimtarisë së organeve të drejtësisë.

Qëllimi i bashkëpunimit është vendosja e komunikimit në vijimësi mes shoqërisë civile dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes proceseve transparente të monitorimit të veprimtarisë dhe rritjes së besimit të publikut në drejtim të ndërgjegjësimit të opinionit publik mbi misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi dhe në respektim të kushteve të marrëveshjes janë hartuar dy kontribute, në kuadër të monitorimit të aktiviteteve dhe indikatorëve për ILD-në sipas aktiviteteve të planifikuara në planin e veprimit të Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë 2021-2025, dhe informacionit në funksion të monitorimit.

Gjithashtu janë organizuar dy tryeza të organizuara nga Instituti për Studime Publike e Ligjore (ISPL) palë e marrëveshjes, ku janë diskutuar gjetjet, rezultatet dhe konkluzionet e monitorimit.

Takimi i punës i fundvitit mes ILD-së dhe organizatave nënshkruese prodhoi ide të cilat do të materializohen me aktivitete të tjera gjatë vitit 2023, të iniciuara nga këto organizata, si në pikëpamjen e monitorimit të institucionit ashtu edhe në drejtim të komunikimit publik mbi rolin dhe funksionet e ILD-së.

#### **4.6. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë**

Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, si në drejtim të rritjes e fuqizimit të kapaciteteve të zyrës së ILD-së, ashtu edhe në shkëmbimin e praktikave më të mira të punës, ka qenë një prioritet edhe për vitin 2022. Në këtë drejtim janë arritur disa bashkëpunime të rëndësishme:

Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe Inspektoratit Gjyqësor të Republikës së Rumanisë, në datë 08.02.2022 dhe ka si objekt bashkëpunimin në projekte të përbashkëta dhe vizita studimore, si edhe shkëmbime eksperiencash e informacioni lidhur me praktikatat më të mira të punës për zhvillimin me sukses të aktivitetit të inspektorateve të drejtësisë në Shqipëri dhe Rumani<sup>14</sup>.

Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit me drejtuesen e Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Italisë, në datën 24.03.2022<sup>15</sup>, duke synuar fuqizimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, në kuadër të procedurave të inspektimit dhe hetimit disiplinor ndaj magjistratëve.

<sup>14</sup> Për më tepër, mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/02/09/inspektore-te-ild-shkembim-eksperience-me-homologet-rumune/>

<sup>15</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/03/24/inspektimi-dhe-hetimi-disiplinor-ild-nenshkrues-marreveshje-bashkepunimi-me-homologet-italiane/>

Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, në datën 24.10.2022<sup>16</sup>, duke patur si objekt zhvillimin e bashkëpunimit mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, duke zhvilluar veprimtari e programe të përbashkëta dhe duke shkëmbyer njohuri në fushën e drejtësisë.

Si pjesë e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ) edhe pse me statusin e vëzhguesit, duke mos qenë Shqipëria vend anëtar i BE-së, Inspektori i Lartë i Drejtësisë arriti të bashkonte në Tiranë në një konferencë ndërkombëtare, homologë të vendeve të BE-së, anëtarë të RESIJ e të tjerë, si dhe profesionistë të spikatur të së drejtës, rreth temës “Interesi i publikut dhe pavarësia e magjistratëve” në Tiranë, në datat 24 dhe 25 qershor 2022<sup>17</sup>. Konferenca u organizua në bashkëpunim me RESIJ dhe me mbështetjen e CEPEJ, programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “*Instrumenti horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022*”.

Pjesëmarrja në takimin dy palësh BE-Shqipëri, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka parashtruar gjendjen dhe problematikat e sistemit llogaridhënës në Bruksel, në kuadër të proceseve të diktuar nga Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me fokus funksionet e ILD-së, të dhëna statistikore për shqyrtimin e ankesave, hetimet dhe procedimet disiplinore, si dhe rezultatet e kërkesave për procedim dhe inspektimet. Gjithashtu, në takim u trajtuan edhe nëntematika që adresojnë edhe aspekte të administrimit të përgjithshëm të veprimtarisë, si buxheti, struktura, burimet njerëzore, pavarësia, duke përfshirë zgjedhjen, mbarimin e mandatit, papajtueshmërinë dhe përgjegjësia disiplinore e ILD-së.

#### **4.7. Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtare, në kuadër të procesit për integrimin evropian**

Më 12 tetor 2022 Komisioni Evropian miratoi dhe publikoi Raportin e Progresit për Shqipërinë për vitin 2022, duke paraqitur një vlerësim të detajuar vjetor të progresit e reformave të kryera gjatë vitit të kaluar, si dhe rekomandimet e udhëzimet për prioritetet e reformave. Në këtë raport, Komisioni ka bërë vlerësimin e punës edhe për institucionet e reja të drejtësisë dhe në veçanti për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, evidenton se “*ILD është duke funksionuar dhe ka iniciuar dhe drejtuar hetimet disiplinore ndaj magjistratëve. ILD-ja vazhdon të ketë mungesë të personelit dhe nuk është arritur reduktimi i ngarkesës së akumuluar, pavarësisht nga plotësimi i disa vendeve vakante, marrjes së ambienteve dhe rritjes së buxhetit. Rekrutimi i inspektorëve shtesë dhe përmirësimi i kapaciteteve mbetet i nevojshëm. Shumica e kërkesave të ILD-së për shkarkimin e prokurorëve u refuzuan nga KLP në vitin 2021. Bashkëpunim i ngushtë ndërmjet organeve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë duhet të vijojë*”.

<sup>16</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/10/24/ild-memorandum-bashkepunimi-me-fakultetin-juridik-te-universitetit-te-prishtines/>

<sup>17</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/06/22/interesi-i-publikut-dhe-pavaresia-e-magjistratëve-inspektori-i-larte-i-drejtësisë-mbledh-ne-tirane-homologet-evropiane/>

Konkretisht, sipas Progres Raportit për Shqipërinë, për vitin 2022<sup>18</sup>, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kryer plotësisht funksionet e tij gjatë periudhës raportuese, veçanërisht duke filluar dhe kryer hetime disiplinore ndaj magistratëve. Krahas vlerësimit të punës, Komisioni ka theksuar nevojën për:

- Rekrutim të inspektorëve shtesë dhe përmirësim të kapaciteteve;
- Reduktim të ngarkesës.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të sipërpërmendura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, gjatë vitit 2022, në funksion të emërimeve të inspektorëve ka përmbyllur procesin e rekrutimit në datën 11.10.2022, ku me vendimin nr. 44, datë 11.10.2022 “Për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant për inspektor jomagjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021”<sup>19</sup>, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka vendosur miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve, sipas totalit të pikëve për secilin kandidat në procedurë konkurrimi për pozicionet vakante për inspektorë jomagjistratë. Numri aktual i inspektorëve është 12, prej të cilëve, 8 inspektorë jomagjistratë dhe 4 inspektorë magistratë.

Lidhur me reduktimin e ngarkesës, ILD, krahas marrjes së masave të karakterit organizativ dhe funksional ku ka miratuar aktet e nevojshme për priorizim të shqyrtimit të ankesave, parë edhe dinamikën e ecurisë së inspektimeve dhe situatën faktike të burimeve njerëzore në institucion, ka bërë një rishpërndarje të ankesave të mbetura për trajtim, me synim përfshirjen në shqyrtimin e tyre edhe inspektorët e rinj. Stafii administrativ është angazhuar në aspekte tepër teknike administrative për të lehtësuar fluksin e qarkullimit dhe komunikimit të dokumentacionit, duke ofruar mbështetjen e inspektorëve aktualë në ushtrimin e veprimtarisë, pa patur rol përcaktues në trajtim.

Sa i takon kërkesave të rrëzuara, Komisioni u referohet disa rasteve nga periudha të mëparshme të raportimit, ku është përdorur terminologjia “rrëzuar”. Përdorimi i këtij termi ka patur si synim përdorimin korrekt të parashikimit ligjor të përcaktuar në nenin 146, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Pranimi ose rrëzimi është akti procedural, me anë të të cilit disponojnë Këshillat për vendimet ndaj kërkesave për procedim të paraqitura nga ILD. Në këtë drejtim, gjatë takimit në Bruksel, në 24-25 nëntor 2022, është sqaruar se vendimet e rrëzuara, në thelb janë të pranuar pjesërisht, pasi kanë patur të bëjnë me raste të ndryshimit të masës së dhënë. Në asnjë rast nuk është cenuar ligjshmëria e hetimit, verifikimit të shkeljeve apo vetë ekzistenca e saj, por ndryshimi ka të bëjë me llojin e masës disiplinore të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në çdo rast, Këshilli përkatës edhe pse ka konfirmuar shkeljen disiplinore, në ushtrim të diskrecionit, ka vendosur për një masë më pak të rëndë ose e ka referuar çështjen për vlerësim të brendshëm profesional të magistratëve.

<sup>18</sup> <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

<sup>19</sup> Inspektori i Lartë i Drejtësisë. (11.10.2022). “Për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant për inspektor jomagjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021”. Marrë prej: <https://ild.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim-per-renditjen-perfundimtare-Inspektore-Jo-Magjistrate.pdf>

Për një rast, ILD i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, me objekt padie: “Shfuqizim/paligjshmëri akti administrativ, ndaj një vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me anë të të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedimin disiplinor të një magjistrati dhe zgjidhjen e pasojave të paligjshmërisë, pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe caktimin ndaj magjistratit të masës disiplinore “Vërejtje publike”. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të padisë së palës paditëse”, duke shfuqizuar vendimin e KLP-së dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera. Kjo çështje gjyqësore rezulton të jetë e përfunduar me vendim të formës së prerë në apel. Çështja është rekursuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe rekursi nuk është shqyrtuar ende në Gjykatën e Lartë.

## V. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

### 5.1. Komandime nga KLGJ

Për plotësimin e strukturës organizative dhe veçanërisht Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë marrë disa masa, të cilat kanë patur si qëllim realizimin e komandimeve të magjistratëve me profilin gjyqtar.

Gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur kërkesën për komandimin e magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e Këshilltarit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas konsultimit me informacionin e publikuar në faqen zyrtare të KLGJ-së, rezulton se me vendimin nr. 486, datë 14.11.2022 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”<sup>20</sup>, ka vendosur: “Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për: “Këshilltar””.

Gjatë vitit 2022 nuk ka patur asnjë komandim për inspektor në institucion. Nga ana tjetër, një inspektor magjistrat i komanduar, i cili po vijon punën pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka paraqitur kërkesën për ngritje në detyrë, kërkesë e cila pritet të shqyrtohet nga KLGJ-ja.

### 5.2. Komandime nga KLP

<sup>20</sup> Këshilli i Lartë Gjyqësor. (14.11.2022). “Njoftim për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Marrë prej:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/11/NJOFTIM-I-DAT%C3%8BS-14.11.2022-P%C3%8BR-SHPALLJEN-E-K%C3%8BRKES%C3%8BS-P%C3%8BR-KANDIDATURA-NGA-RADH%C3%8BT-E-GJYQATAR%C3%8BVE-P%C3%8BR-KOMANDIM-N%C3%8B-ZYR%C3%8BN-E-INSPEKTORIT-T%C3%8B-LART%C3%8B-T%C3%8B-DREJT%C3%8BSIS%C3%8B.pdf>

Gjatë vitit 2022, nuk ka patur asnjë kërkesë për komandim drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke qenë se në Njësinë e Inspektorëve, në radhët e inspektorëve magjistratë 3 prej 4 inspektorëve, vijnë nga radhët e magjistratëve me profil prokuror.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, synon krijimin e një balance nëpërmjet inspektorëve magjistrat me profil gjyqtar dhe prokuror në organikën e Njësisë së Inspektorëve, andaj edhe nuk ka paraqitur kërkesë për komandim për magjistratë të profilit prokuror.

### **5.3. Rekrutim i inspektorëve jomagjistrat**

Gjatë vitit 2022 ka përfunduar procedura e rekrutimit të inspektorëve jomagjistratë, e shpallur në datën 30.09.2021, në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të neneve 209 dhe 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, si dhe të Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Procesi i rekrutimit ka përfunduar në datën 11.10.2022, ku me vendimin nr. 44, datë 11.10.2022 “Për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant për inspektor jomagjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021”<sup>21</sup>, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka vendosur: “*Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve, sipas totalit të pikëve për secilin kandidat në procedurë konkurrimi për pozicionet vakante për inspektor jomagjistrat*”.

Rritja e numrit të inspektorëve, në fund të tetorit 2022, ka patur ndikim të lehtë në rritjen e trajtimit të ankesave të backlog-ut. Rezultate në rritje për përfundimin e shqyrtimit të ankesave backlog, do të arrihen gjatë 6-mujorit të parë të viti 2023, periudhë në të cilën pritet të përfundohet backlog.

### **5.4. Zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil” në kuadër të plotësisimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore**

Gjatë vitit 2022, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kodit të Punës dhe ligjit organik, janë realizuar në total 14 (katërmbëdhjetë) emërim/rekrutime brenda strukturës së miratuar dhe 9 (nëntë) punonjës mbi numrin e miratuar të strukturës, si më poshtë:

<sup>21</sup> Inspektori i Lartë i Drejtësisë. (11.10.2022). “Për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant për inspektor jomagjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021”. Marrë prej: <https://ild.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim-per-renditjen-perfundimtare-Inspektore-Jo-Magjistrate.pdf>

|                            |  |
|----------------------------|--|
| 1. Kabineti                | 2 (dy) emërimë Këshilltarë (2 Këshilltarë janë larguar në muajt shtator dhe tetor 2022 me dorëheqje)         |
| 2. Inspektor Magjistrat    | 0 (zero)   |
| 3. Inspektor jomagjistrat  | 4 (katër)  |
| 4. Niveli i Lartë Drejtues | 0 (zero)   |
| 5. Niveli i Mesëm Drejtues | 2 (dy) Ndhmës Inspektorë (1 lëvizje paralele dhe 1 rikthim në përfundim të periudhës së pezullimit)          |
| 6. Niveli i Ulët Drejtues  | 1 (një) Përgjegjës, (ngritje në detyrë);   |
| 7. Niveli ekzekutiv        | 3 (tre) Specialistë (pranim në shërbim civil), (liruar me dorëheqje 3 specialistë);                          |
| 8. Punonjës me Kod Pune    | 2 (dy) Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme (liruar 2 me dorëheqje) dhe 9 punonjës me kontratë të përkohshme |

Totali i emërimeve për vitin 2022 brenda strukturës së miratuar është 14 punonjës/nëpunës.

Numri i punonjësve sipas strukturës për vitin 2022 është 93 punonjës të miratuar. Totali i punonjësve që ushtrojnë efektivisht detyrën është 80, nga të cilët 71 punonjës brenda strukturës së miratuar dhe 9 punonjës me kontratë të përkohshme.

### 5.5. Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve

Gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, së bashku me Njësinë e Inspektorëve dhe Njësinë e Ndhmësinspektorëve kanë ndjekur një sërë trajnimesh, konferencash dhe kanë realizuar shkëmbime eksperiencash, duke u fokusuar në zhvillimin profesional, si edhe standardizimin dhe unifikimin e praktikës së veprimtarisë inspektuese.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë, lidhur me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që nga krijimi i institucionit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është fokusuar në rritjen e bashkëpunimit me aktorë të fushës akademike, duke nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me fakultetet e drejtësisë së universiteteve shtetërore brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Viti 2022 ka patur shkëmbime të eksperiencave midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe aktorëve të tjerë, në kuadër të zhvillimit, trajnimit dhe standardizimit të proceseve të punës së punonjësve por edhe vetë institucionit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

### 5.5.1. Shkëmbime eksperiencash

Sa i përket shkëmbimeve të eksperiencave gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka nënshkruar marrëveshje dhe ka marrë pjesë në aktivitetet e mëposhtme:

#### 1. Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe Inspektoratit Gjyqësor të Republikës së Rumanisë

Memorandumi u nënshkrua në Bukuresht në datën 08.02.2022 dhe ka si objekt bashkëpunimin në projekte të përbashkëta dhe vizita studimore, si edhe shkëmbime eksperiencash e informacioni lidhur me praktikën më të mira të punës për zhvillimin me sukses të aktivitetit të inspektorateve të drejtësisë në Shqipëri dhe Rumanisë<sup>22</sup>.

#### 2. Vendosja e një komunikimi të vazhdueshëm mes shoqërisë civile dhe Zyrës së ILD-së

Marrëveshja e bashkëpunimit mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe gjashtë organizatave të shoqërisë civile u nënshkrua në datën 16.03.2022.

Marrëveshja me ILD-në u nënshkrua nga Instituti për Studime Publike e Ligjore (ISPL), Instituti i Studimeve Politike (ISP), Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (IBZH), Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), Qendra Evropiane (QE), dhe Instituti Shqiptar i Shkencës/Open Data Albania<sup>23</sup>.

#### 3. Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit me drejtuesen e Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Italisë

Marrëveshja e mirëkuptimit u nënshkrua në datën 24.03.2022<sup>24</sup>, duke synuar fuqizimin e marrëdhënieve ndër-institucionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, në kuadër të procedurave të inspektimit dhe hetimit disiplinor ndaj magjistratëve.

#### 4. Bashkëpunimi me Fakultetet e Drejtësisë në universitetet publike

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 21.10.2022, zhvilloi një takim pune me rektorët e universiteteve publike, të Universitetit të Tiranës, Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, me fokus vendosjen e urave të bashkëpunimit në funksion të përgatitjes së studentëve me praktikën e punës dhe funksioneve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë<sup>25</sup>.

<sup>22</sup> Për më tepër, mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/02/09/inspektore-te-ild-shkembim-eksperience-me-homologet-rumune/>

<sup>23</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/03/16/inspektori-i-larte-i-drejtësisë-nënshkruan-marreveshje-bashkëpunimi-me-6-organizata-te-shoqërisë-civile/>

<sup>24</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/03/24/inspektimi-dhe-hetimi-disiplinor-ild-nënshkruan-marreveshje-bashkëpunimi-me-homologet-italiane/>

<sup>25</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/10/21/bashkëpunimi-me-universitetet-si-dimension-i-rendesishem-i-vizionit-te-ild-se/>

## 5. Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës

Memorandumi i bashkëpunimit u nënshkrua në Prishtinë në datën 24.10.2022<sup>26</sup>, duke patur si objekt zhvillimin e bashkëpunimit mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, duke zhvilluar veprimtari dhe programe të përbashkëta, duke shkëmbyer njohuri në fushën e drejtësisë.

### 5.5.2. Pjesëmarrje në konferenca shkencore

Lidhur me pjesëmarrjen në konferenca shkencore gjatë vitit 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe stafi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka marrë pjesë në këto konferenca:

#### 1. Tema: “Drejtësi në kohë sfidash”

Konferenca u mbajt në datën 09.05.2022<sup>27</sup>, e organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “*Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022*”, me rastin e Ditës Kombëtare të Drejtësisë.

#### 2. Tema: “Mbështetje rajonale për të përforcuar të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracinë në Mesdheun Jugor (Programi i Jugut IV)”

Konferenca e mbajtur në datën 11.05.2022<sup>28</sup> në Kazablanka, Marok, u organizua nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), në bashkëpunim me Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) dhe Inspektoratin e Përgjithshëm të Çështjeve Gjyqësore të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit (CSPJ).

#### 3. Tema: “Interesi i publikut dhe pavarësia e magjistratëve”

Konferenca ndërkombëtare u organizua nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ), në bashkëpunim me CEPEJ (Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri, SEJ III), e me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “*Instrumenti horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022*” dhe u mbajt në Tiranë në datat 24 dhe 25 qershor 2022<sup>29</sup>.

#### 4. Tema: “Instrumenti Horizontal të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”

<sup>26</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/10/24/ild-memorandum-bashkepunimi-me-fakultetin-juridik-te-universitetit-te-prishtines/>

<sup>27</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/05/09/fjala-e-inspektorit-te-larte-te-drejtises-ne-konferencen-drejttesi-ne-kohe-sfidash/>

<sup>28</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/05/11/inspektori-i-larte-metani-merr-pjese-ne-konferencen-rajonale-te-sherbimeve-te-inspektimit-te-mesdheut-jugor/>

<sup>29</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/06/22/interesi-i-publikut-dhe-pavaresia-e-magjistrateve-inspektori-i-larte-i-drejtises-mbledh-ne-tirane-homologet-evropiane/>



Konferenca rajonale u mbajt në Budva të Malit të Zi në 28.09.2022<sup>30</sup>. Në konferencën përmbyllëse të programit “Instrumenti Horizontal të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, krahas Shqipërisë merrnin pjesë edhe Kosova, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

5. Tema: **“Diskutim mbi raportin e punës së bërë gjatë vitit 2022 dhe programit për vitin 2023 në Asamblenë e Përgjithshme të RESIJ”**

Asambleja e përgjithshme e RESIJ u mbajt në 17 dhjetor 2022 në Bruksel<sup>31</sup>, e u mikprit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë së Belgjikës. Anëtarët e rrjetit diskutuan mbi raportin e punës së bërë gjatë vitit 2022 dhe programin për vitin 2023.

5.5.3. *Veprimtari trajnuese*

Sa i përket veprimtarive trajnuese gjatë vitit 2022, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, ka marrë pjesë në trajnimet si më poshtë:

**1. Inspektoratin e Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës së Madhërisë së Saj (HMCPSI)**

Tema: “Mbi procesin e inspektimeve”

Trajnimi u mbajt *online* në datën 27.07.2022<sup>32</sup>, ku u diskutua rreth procedurës së inspektimeve, përcaktimin dhe planifikimin e tyre, mënyrën e organizimit, para-inspektimi, vizitat në vendndodhje, vlerësimin e situatës si edhe përgatitjen e raportit hetimor.

**2. Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE)**

Tema: “Vlerësimi i risqeve të korrupsionit në hartimin/rishikimin e legjislacionit”

Trajnimi u mbajt në Tiranë në datat 12 dhe 13 dhjetor 2022, ku u diskutua rreth vlerësimit të risqeve të korrupsionit gjatë hartimit të legjislacionit dhe impaktit që legjislacioni i hartuar sjell për publikun e gjerë dhe organet publike.

<sup>30</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/09/28/bashkepunimi-me-cepej-histori-suksesi-per-ild-ne/>

<sup>31</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/09/28/bashkepunimi-me-cepej-histori-suksesi-per-ild-ne/>

<sup>32</sup> Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2022/07/27/ekipi-i-ild-se-trajnim-me-inspektoratin-britanik-mbi-inspektimet/>

## VI. TË DHËNA MBI PROCESËT GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deri më 31 dhjetor 2022, ka qenë palë e proceseve si më poshtë:

### 6.1. Procese në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

#### 6.1.1. Çështje të përfunduara

1. Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 3/2021 datë 30.04.2021, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur me cilësinë e subjektit të interesuar, bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me kërkues magjistratin B. M., prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit”. Në përfundim të gjykimit të çështjes së juridiksionit disiplinor, Kolegji i Posaçëm i Apelit gjykoi se shkeljet e magjistratit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në vendimet objekt procedimi disiplinor dhe gjykimi pranë Kolegjit, të konstatuara nga ILD-ja dhe të shqyrtuara dhe konkluduara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, janë të tilla që e ngarkojnë magjistratin me përgjegjësi disiplinore dhe se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, e dhënë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera prej tij.  
Me vendimin nr. 1, datë 30.05.2022, Kolegji vendosi: “Mospranimin e ankimit të magjistratit B. M., kundër vendimit nr. 81, datë 31.03.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit B. M. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare”. Vendimi nr. 1, datë 30.5.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, shpallur në datën 12.7.2022, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë 29.7.2022.
2. Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 4/2021 datë 21.05.2021, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur me cilësinë e subjektit të interesuar bashkë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me kërkues magjistratin E. H., gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me objekt: “Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 92, datë 17.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Në përfundim të gjykimit të çështjes së juridiksionit disiplinor, Kolegji i Posaçëm i Apelit gjykoi se shkeljet e magjistratit gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, në dhënien e vendimeve objekt procedimi disiplinor, të konstatuara nga ILD-ja dhe të shqyrtuara dhe konkluduara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor janë të tilla që e ngarkojnë magjistratin me përgjegjësi disiplinore dhe se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, e dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera.

Me vendimin nr. 2, datë 31.05.2022, Kolegji i Posaçëm i Apelimit vendosi: “Mospranimin e ankimit të magjistratit E. H., kundër vendimit nr. 92, datë 17.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit E. H.”. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare”. Vendimi nr. 2, datë 31.05.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, shpallur në datën 30.06.2022, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 100, datë 06.07.2022.

3. Çështje të juridiksionit disiplinor nr. 2/2021, datë 26.03.2021, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur me cilësinë e subjektit të interesuar bashkë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me kërkues magjistratin M. K., gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt: Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Lartë gjyqësor “Për caktimin e masës disiplinore ndaj një magjistrati dhe rivendosja e të drejtave të kufizuara të kësaj vendimmarrjeje”. Në përfundim të gjykimit të çështjes së juridiksionit disiplinor Kolegji i Posaçëm i Apelimit, gjykoj se masa disiplinore e shkarkimit e vendosur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është proporcionale me shkeljet e kryera, të cilat konsiderohen si akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit.

Nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 07.12.2022, Kolegji i Posaçëm i Apelimit vendosi: “Mospranimin e ankimit të magjistratit, M. K., kundër vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit M. K.”. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare”. Vendimi nr. 3, datë 07.12.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është shpallur në datën 06.01.2023.

#### *6.1.2. Çështje në proces shqyrtimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

1. Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 1/2022, datë 16.02.2022, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me kërkues magjistratin Sh. K., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me objekt: “Shfuqizimi si një vendim në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit Sh. K.” dhe deklarimin absolutisht të pavlefshëm të shkarkimit për shkelje të të drejtave të njeriut në procesin administrativ dhe për proces të parregullt ligjor, që bie ndesh me nenin 6 të KEDNJ dhe një sërë nenesh të Kushtetutës. Rivendosja e të drejtave të kufizuara prej kësaj vendimmarrjeje”.

Çështja e juridiksionit disiplinor është në proces shqyrtimi në seancë plenare mbi bazë dokumentesh në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

2. Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 2/2022, datë 20.06.2022, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar, bashkë me Këshillin e Lartë të

Prokurorisë, me kërkues magjistratin B. Z., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me objekt: “Ndryshimin e vendimit nr. 20, datë 31.01.2022, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit B. Z., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; Kthimin në detyrën e prokurores pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Dibër.

Çështja e juridiksionit disiplinor është në proces shqyrtimi në seancë plenare mbi bazë dokumentesh në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

## 6.2. Procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

1. Çështje gjyqësore me palë paditëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë me palë të paditur Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me objekt padie: “Shfuqizim/paligjshmëri akti administrativ, ndaj një vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me anë të të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedimin disiplinor të një magjistrati dhe zgjidhjen e pasojave të paligjshmërisë, pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe caktimin ndaj magjistratit të masës disiplinore “Vërejtje publike”, të parashikuar nga neni 105, paragrafi 1, shkronja “b” dhe neni 107 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ose detyrimin e KLP të vendosë ndaj magjistratit masën disiplinore “Vërejtje publike”, të parashikuar nga neni 105, paragrafi 1, shkronja “a” dhe neni 107 i ligjit nr. 96/2016, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të padisë së palës paditëse”, duke shfuqizuar vendimin e KLP-së dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera. Lidhur me statusin e kësaj çështjeje gjyqësore rezultoi të jetë e përfunduar me vendim të formës së prerë në apel. Çështja është rekursuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe rekursi nuk është shqyrtuar ende në Gjykatën e Lartë.

## 6.3. Procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

1. Çështje gjyqësore ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka qenë palë e paditur me palë paditëse F. H., kandidat i skualifikuar në kuadër të procedurës së rekrutimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me objekt padie: “Shfuqizimin e aktit administrativ të Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur: “Rrëzimin e padisë së paditësit”. Çështja është regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, pas ankimit të F. H., e cila është në fazë përpunimi.

2. Çështje gjyqësore ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka qenë palë e paditur me palë paditëse S. K., kandidat i skualifikuar në kuadër të procedurës së rekrutimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me objekt padie: “Shfuqizimin e aktit administrativ të Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur pushimin e gjykimit, pasi paditësi S. K., bazuar në nenin 201, ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i padisë. Statusi i çështjes gjyqësore rezultoi i përfunduar.

## VII. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

### 7.1. Transparenca në fokus të veprimtarisë

Transparenca dhe mirinformimi vijojnë të jenë në qendër të komunikimit publik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në funksion të ambicies së shpallur, që prej ngritjes së institucionit, se në punën e vet ILD synon gjetjen e balancës midis interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe respektimit të pavarësisë së magjistratëve, pasi sa më i pavarur të jetë magjistrati, aq më i garantuar është qytetari për të drejtat e tij.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i kushton vëmendje të veçantë transparencës me publikun dhe median, si parakusht për rritjen dhe konsolidimin e besimit të publikut tek institucioni në veçanti dhe sistemi i drejtësisë në përgjithësi.

Marrëdhënia efektive me publikun nuk mjaftohet vetëm me komunikimin me të përmes faqes zyrtare të institucionit [www.ild.al](http://www.ild.al), por është synuar një ndërveprim i targetuar përmes përthithjes së çdo mendimi të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Kështu, në ditën e drejtësisë, më 10 Maj 2022 në faqen zyrtare të internetit, u publikua një anketë mbi veprimtarinë e ILD-së, ku përmes një serie pyetjesh, qytetarët ftohen të shprehin mbi institucionin, pavarësisht nëse kanë patur apo jo eksperiencë direkte me të, çfarë kanë konstatuar ata që kanë patur përvojë personale me ILD, etj. Nga të dhënat e anketës synohet që orientimi i veprimtarisë së ILD-së, të përafrohet me ndjeshmëritë e nevojat e publikut, si një kontribut për të përmirësuar në vazhdimësi punën e institucionit e për të forcuar besimin e qytetarëve tek ILD.

Nga data 10 maj, kur u publikua anketa, deri në datën 31 dhjetor 2022, janë plotësuar nga përdorues të shërbimeve të ofruara nga ILD, 49 anketa. Krahasuar me 500 ankesat e konfirmuara gjatë kësaj periudhe, rezultoi se 10% e përdoruesve të kenë ndarë përmes anketës përvojën e tyre, sa i përket shërbimeve të ofruara nga ana e ILD-së. Evidentimi i të dhënave i shërben nevojave për përmirësim, si në nivel dhënie shërbimi, ashtu edhe të kuptimit nëse ndërgjegjësimi ka arritur të përmbushë qëllimin e tij, atë të thjeshtimit të proceseve dhe edukimit të publikut mbi rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë.

## Anketë mbi veprimtarinë e ILD-së

### 1. Sa i informuar jeni mbi funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? Zgjidhni një ose disa nga pohimet e mëposhtme. \*

- Njoh pak sferën e kompetencave të ILD-së.
- Njoh kompetencat e ILD-së, pasi kam lexuar kuadrin ligjor të sistemit të drejtësisë.
- Jam informuar përmes faqes zyrtare të ILD-së.
- Jam informuar nëpërmjet mediave tradicionale/sociale për ILD-në.
- Më kanë informuar të njohur/institucione publike, mbi mundësinë e ankimit ndaj veprimtarisë së magistratëve pranë ILD-së.
- Kam dashur por nuk kam njohur asnjë nga format e komunikimit.

### 2. A jeni ankuar ndonjëherë për veprimtarinë e magistratëve? \*

- Jo, ankoem për herë të parë në ILD.
- Po, kam depozituar ankesë edhe më parë.
- Jo, asnjëherë.

## Programi për informimin dhe komunikimin publik për vitet 2022-2023

Me gjithë punën informuese vihet re se ka ende paqartësi nga ana e qytetarëve për rolin e ILD-së, shpesh për shkak të vështirësisë në kuptimin e ligjeve. Për këtë qëllim, por edhe në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit, me urdhrin nr. 49, datë 30.05.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u miratua programi për informimin dhe komunikimin publik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në të cilin parashtrihen si objektiva bazë: ofrimi i asistencës për ankesuesit; promovimi i veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; garantimi i të drejtës së informimit dhe transparencës, si dhe monitorimi i qasjes së publikut ndaj veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Duke vendosur si prioritet kryesor të programit për informimin dhe komunikimin publik, transparencën ndaj publikut, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë punon sistematikisht për të rritur besimin tek çdo aktor publik, mediatik apo grup interesi. Aksesit plotë në komunikim me institucionin për çdo individ apo institucion të interesuar, si përmes numrit zyrtar të telefonit, email-it zyrtar apo pritja e qytetarëve nga e hëna në të premte janë mënyra përmes të cilave jo vetëm garantohet në përputhje me ligjin e drejta e informimit, por ofrohen të dhëna mbi kompetencat e ILD. Puna e zyrës së ankesave, pika e komunikimit direkt me qytetarët pasqyrohet në një seksion të posaçëm të Buletinit mujor të ILD-së, me statistikat përkatëse.

## 7.2. Faqja e internetit si mënyrë komunikimi e institucionit

Faqja zyrtare e internetit [www.ild.al](http://www.ild.al), është mënyra kryesore e komunikimit të ILD-së me publikun. Informimi përmes faqes bëhet pothuaj në kohë reale me veprimtarinë e institucionit në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe përmbush detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Përmes faqes së internetit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vendosur marrëdhënie proaktive, transparente e informuese me publikun dhe median. Faqja përmirësohet herë pas here në funksion të krijimit të lehtësive për çdo qytetar apo subjekt të interesuar, në kërkimin e informacionit në kohë reale. Përveç materialeve informuese dhe video, rubrikave të dedikuara mbi aktivitetin, vendimet e aktet e ILD-së, përmirësime të vazhdueshme bëhen në drejtim të komunikimit mbi mënyrën se si mund të kryhet ankimi pranë ILD. Rubrika “Si pranohen ankesat”, rifreskohet me raste konkrete orientuese mbi pranueshmërinë e ankesës, ecurinë e saj, arkivimin, ankimin e deri tek hetimi e procedimi disiplinor, të cilat shoqërohen me një ilustrim grafik të gjithë rrugëtimit që ndjek një ankesë në ILD. Ky informacion i përditësuar plotëson atë ekzistues për lehtësim të procesit të ankimit përmes formularit tip të ankesës, me udhëzimet përkatëse për plotësimin dhe adresimin pranë ILD.

## 7.3. Pritja e qytetarëve në mjediset e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Spektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave në ILD realizon pritje me qytetarët në çdo ditë zyrtare pune, nga ora 09.00-14.00. Gjatë vitit 2022 janë asistuar dhe informuar nëpërmjet takimeve dhe linjës telefonike në lidhje me pretendimet/ankimet e tyre për magjistratët, mesatarisht (gjashtë) qytetarë në ditë.

Konkretisht:

- Janë realizuar 246 takime me qytetarë, (mbi bazën e kërkesave me shkrim, të kërkesave më anë të komunikimit me telefon, si dhe pa përcaktim të mëparshëm). Gjatë takimeve, në çdo rast nëpunësit përgjegjës kanë dëgjuar pretendimet, duke i asistuar/informuar për paqartësitë, në lidhje me të drejtat e qytetarëve për t’u ankuar.
- Janë asistuar përmes telefonit, në numrin zyrtar të institucionit 296 qytetarë/subjekte të interesuar, të cilët kryesisht kanë kërkuar informacion mbi fazën në të cilën ndodhen ankesat, mënyrën se si pranohen, si procedohet me paraqitjen e dokumenteve shtesë në mbështetje të pretendimeve të tyre, etj.

## 7.4. E drejta e informimit

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka përbushur në çdo rast përpara afateve detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe nga miratimi i Programit të Transparencës të rishikuar dhe plotësimit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve sipas urdhërimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Informacioni i bërë publik në programin e transparencës, pasqyron në mënyrë shteruese veprimtarinë e ILD-së, nëpërmjet publikimit të detajuar në faqen zyrtare [www.ild.al](http://www.ild.al), si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyron në rubrika, tekste/përmbajtje, afate të përcaktuara kohore për bërjen publike të informacionit, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon apo administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet qartë vendndodhja e informacionit zyrtar në hartën e faqes së internetit dhe përditësimi, si në formë dhe përmbajtje.

Gjatë vitit 2022 pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 138 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda afateve ligjore.


Asnjë kërkesues nuk rezulton të jetë ankuar në autoritetet përkatëse për:

- a) mungesë informacioni;
- b) informacion të paqartë;
- c) tejkallim të afateve ligjore dhe
- ç) refuzim të dhënies së informacionit.

Krahasuar me të dhënat e vitit paraardhës konstatohet një rritje sasiore dhe cilësore e trajtimit të kërkesave për informacion. Duke e konsideruar tregues progresiv të rritjes së besimit të publikut tek institucioni, administrata e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ka trajtuar brenda një harku të shkurtër kohor kërkesat për informacion nga qytetarët, media, grupet e interesit apo organizatat e shoqërisë civile. Mesatarisht në javë, për vitin 2022 janë trajtuar tre kërkesa për informacion.

Referuar të dhënave publike, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2020, ka trajtuar 14 kërkesa për informacion, për vitin 2021, ka trajtuar 114 kërkesa për informacion dhe për vitin 2022, ka trajtuar 138 kërkesa për informacion.





### 7.5. Si komunikon ILD me publikun?

Në funksion të transparencës për veprimtarinë e institucionit por edhe aksesin e publikut edhe gjatë vitit 2022 janë përdorur mënyrat klasike të komunikimit, duke përmirësuar elementë për rritjen e efikasitetit të punës. Vëmendja maksimale ka qenë tek:

- Faqja zyrtare [www.ild.al](http://www.ild.al) e përditësuar në informacion, në shqip dhe anglisht.
- Në faqen zyrtare, çdo të hënë vijon të publikohet ecuria e javore e punës në ILD sa i takon numrit të ankesave të administruara, atyre të trajtuara, atyre në proces trajtimi fillestar, verifikimi, arkivimi, hetimet dhe procedimet disiplinore.
- Posta elektronike [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si mënyrë e shpejtë komunikimi për dërgimin e ankesave/dokumenteve, apo për të kërkuar informacion.
- Numri zyrtar i telefonit, për një komunikim në kohë reale me publikun, institucione e qytetarë të interesuar, një nga mënyrat për të garantuar të drejtën për informim.
- Pritja e qytetarëve çdo ditë pune, nga e hëna në të premte (nga ora 09.00-14.00) duke i asistuar sipas nevojës në plotësimin e formularit TIP të ankesës përmes punonjësve të Sektorit të Ndihmës Juridike dhe Ankesave, si strukturë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.
- Buletini mujor i ILD-së vijoi edhe gjatë vitit 2022 të ishte informues periodik mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Buletini është dy gjuhësh, shqip dhe anglisht, gjendet në faqen zyrtare të ILD dhe ka opsionin e abonimit falas për të gjithë të interesuarit.

- Llogaria zyrtare e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në aplikacionin *Twitter* shërben gjithashtu si mënyrë e shpejtë dhe koncize komunikimi publik.
- Kanali *youtube* i ILD rifreskohet me aktivitetet, intervistat video të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Komunikimi i drejtpërdrejtë me grupet e interesit në funksion të informimit mbi rolin dhe funksionet e ILD-së.

## 7.6. Komunikimi me median si mënyrë për të arritur tek publiku

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vendosur një marrëdhënie korrekte bashkëpunuese me mediat, si ndërmjetëse me opinionin publik, duke u përpjekur t'u përcjellë informacion në kohë reale mbi veprimtarinë e institucionit, duke i përgjigjur interesimit të tyre mbi aspekte të ndryshme të punës së ILD-së, e duke i kushtuar vëmendje të veçantë monitorimit të mediave, me qëllim vjeljen e informacionit mbi denoncimet e ndryshme për rastet e shkeljeve të pretenduara disiplinore të magjistratëve.

Gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nënvizuar fort në komunikimin e tij se interesi i publikut për administrimin e drejtësisë duhet të shkojë paralel me respektimin e pavarësisë së magjistratëve, si një balancë që i jep vlerë shtetit të së drejtës. Mënyrat se si aktivizohet Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për denoncime publike janë të parashikuara në ligj dhe gjatë vitit 2022 edhe për shkak të dinamikave që kanë patur në fokus sistemin e drejtësisë, i është kushtuar vëmendje e posaçme këtij sqarimi publik, një proces që vijon edhe në vitin 2023. Përmes intervistave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo komunikimeve për shtyp, është sqaruar se nëpërmjet një informacioni të bërë publik mund të renditen një tërësi zhvillimesh, të cilat pretendohen se kanë ndodhur, por Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me këto të dhëna apo informacione, në raport me shkelje disiplinore, të cilat mund të jenë kryer nga ana e magjistratëve.

Evidentimi i këtyre mesazheve sqaruese edhe përmes videove përkatëse, të publikuara në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale, kanë synuar qartësimin publik së pari se adresimi i çdo pretendimi për shkelje disiplinore nga ana e magjistratëve duhet të bëhet institucionalisht në ILD, përmes paraqitjes së një ankese e më tej një rikujtesë e kompetencave të ILD-së, të cilat në raste të caktuara ngatërrohen me ato të gjykatave më të larta sa i takon pretendimeve për vendimet e gjyqtarëve.

Pjesë e komunikimit publik përmes mediave ka qenë edhe sqarimi i metodikës së punës së ILD-së, në raport me trajtimin e ankesave që bëhet sipas një radhe përparësie të bazuar në kritere si koha, tipologjia ose urgjenca e trajtimit të tij, respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e tij.

Gjatë vitit 2022 janë **59** njoftime, intervista televizive, takime dypalëshe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me aktorë kombëtarë e ndërkombëtarë, mesazhe sensibilizuese, tryeza të rrumbullakëta

me grupet e interesit, apo edhe studentë të drejtësisë, me fokus informimin e plotë e transparent të publikut dhe mediave.

## VIII. PERFORMANCA FINANCIARE

Për vitin 2022 me ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë iu miratua një buxhet prej 266.8 milionë lekë, nga i cili:

1. Për shpenzime korrente 202.8 milionë lekë.
2. Për investime 64 milionë lekë.

Nisur nga ecuria e realizimit të tij gjatë vitit 2022, buxheti i ILD pësoi ndryshime e konkretisht:

➤ Për grupin e shpenzimeve korrente:

Mosplotësimi i vendeve vakante për pozicionet “Inspektor” krijoi fonde të lira veçanërisht në zërat “Paga” e “Sigurime” dhe si rrjedhojë, me Aktet Normative nr. 3, datë 12.03.2022, nr. 12, datë 29.08.2022 dhe nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, ky buxhet pësoi një reduktim prej rreth 51.3 milionë lekë në këtë grup shpenzimesh.

➤ Buxheti për Investimet sipas projekteve, i detajuar si më poshtë:

- Për projektin “Rikonstrukcion i ambienteve të godinës së ILD”, në ligjin vjetor të buxhetit 2022, u planifikua fondi në vlerën 60 milionë lekë. Në përfundim të procedurës së prokurimit, me lidhjen e kontratës me operatorin fitues, u bë i mundur realizimi i pjesshëm i fondit të miratuar. Për këtë arsye, fondi i papërdorur në vlerën 48 milionë lekë u pakësua me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.
- Për blerje pajisje zyre, me një buxhet të miratuar në vlerën 3 milionë lekë; duke qenë se gjatë viteve 2022-2023 do të kryhet dhe rikonstrukcioni i godinës, ky fond u kalua nëpërmjet transferimit, me qëllim realizimin e blerjes së licencave për përdoruesit e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve (SMAD) të dhuruar nga projekti EURALIUS V në muajin shkurt të vitit 2022 në shumën 2 milionë lekë, si dhe për shtesë fondi për blerje të pajisjeve informatike në shumën 1 milion lekë.
- Për vitin 2022, me buxhetin në dispozicion prej 2 milionë lekë, u realizua blerja e pajisjeve informatike të nevojshme për stafin e ILD.

Në mbyllje të vitit 2022, realizimi i buxhetit të rishikuar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas zërave të shpenzimeve dhe në total është si më poshtë:

| Zërat e shpenzimeve: | Plani      | Fakti      | Realizimi |
|----------------------|------------|------------|-----------|
|                      | (000 lekë) | (000 lekë) | (%)       |

|                           |                |                |             |
|---------------------------|----------------|----------------|-------------|
| 1. Paga                   | 99.550         | 98.134         | 98.6        |
| 2. Sigurime               | 15.000         | 14.511         | 96.7        |
| 3. Shpenzime operative    | 34.413         | 26.245         | 76.3        |
| 4. Të tjera korrente      | 2.480          | 1.240          | 50.0        |
| 5. Investime              | 16.000         | 15.391         | 96.2        |
| <b>TOTAL BUXHETI 2022</b> | <b>167.443</b> | <b>155.521</b> | <b>92.8</b> |

Për vitin 2022 zhvillimi i procedurave të prokurimit publik nga Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme është kryer në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2022 të miratuar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë realizuar procedurat e prokurimit publik si më poshtë:

#### **Tabelë treguese e procedurave të prokurimit publik të realizuara për vitin 2022.**

| <b>Nr.</b> | <b>Tipi i procedurës së prokurimit publik</b>    | <b>Kufiri monetar referuar ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”</b> | <b>Total</b> |
|------------|--|--|--------------|
| <b>1</b>   | Procedurë e hapur (Punë)                         | Mbi<br>10 000 000 lekë   | 1            |
| <b>2</b>   | Procedurë e hapur e thjeshtuar                   | Nga 1 000 000 lekë-<br>10 000 000 lekë                                     | 2            |
| <b>3</b>   | Blerje me vlerë të vogël                         | Nga 100 000 lekë-<br>1 000 000 lekë  | 11           |
| <b>4</b>   | Blerje nën 100 000 lekë                          | Blerje nën 100 000 lekë  | 33           |
| <b>5</b>   | Blerje dinamike e biletave për transportin ajror | Blerje dinamike  | 6            |
|            | <b>TOTAL</b>                                     |  | <b>53</b>    |

Njëkohësisht regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2022 është i publikuar dhe në sistemin e prokurimit publik të Agjencisë së Prokurimit Publik [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

## IX. PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE

Edhe viti 2022 u karakterizua, si një vit pune me ngarkesë të theksuar, për shkak të mungesave në kapacitete njerëzore e infrastrukturore. Më gjithë këto sfida Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rendit këto arritje:

1. Trajtimin me prioritet, shpejtësi dhe reduktim të konsiderueshëm të ankesave të backlog-ut. Trajtimi i tyre i jep siguri magistratit në funksion, se çdo ankese ndaj tij i është dhënë zgjidhje në përputhje me dispozitat ligjore për procedimin disiplinor. Ndërkohë që me trajtimin e ankesave backlog edhe qytetarët kanë marrë përgjigje të argumentuara për pretendimet e tyre, ndaj veprimtarisë së magistratëve.
2. Krahas procedimit disiplinor ILD ka ndjekur dhe përfunduar 2 inspektime tematike. ILD nuk është fokusuar vetëm në verifikimin dhe mbështetjen me prova dhe argumente ligjore për procesin e procedimit disiplinor, por ka përfunduar pavarësisht volumit sasior dy inspektime tematike. Referuar qëllimit dhe objektivave, inspektimet do të ndikojnë jo vetëm në vlerësimin e veprimtarisë të zyrave të prokurorive ku u zhvilluan inspektimet, por dhe në dhënien e rekomandimeve konkrete të karakterit legjislativ, organizativ dhe të funksionimit. Rezultatet e efekteve në sistem do të jenë të matshme, nga niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi. Ky dimension i punës së ILD do vijojë edhe gjatë vitit 2023.
3. Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka luajtur një rol proaktiv në kuadër të zhvillimit të procedurave administrative të verifikimit apo hetimit të shkeljeve disiplinore, për të cilat është pretenduar se mund të jenë kryer nga ana e magistratëve, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies të subjekteve të cilët i nështrohen kontrollit nga ana e ILD-së.
4. Rritja e angazhimit të institucionit të ILD-së në krijimin e një sistemi llogaridhënës funksional mbështetur në standardet e përgjshmërisë dhe përgjegjësisë nëpërmjet zhvillimit të inspektimeve tematike, apo iniciimit të procedimeve disiplinore në raste të caktuara, ka sjellë si pasojë një kujdes të shtuar nga ana e magistratëve për të zbatuar drejtë legjislacionin apo institute të së drejtës dhe për rrjedhojë duke rritur cilësinë e vendimmarrjes së tyre.
5. Procedime disiplinore për magistratë pas vlerësimit dhe shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga qytetarët, në funksion të qasjes së shprehur publikisht për vëmendje ndaj qytetarit si ankues, por në të njëjtën kohë dhe ndërgjegjësim të magistratit se institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i kushton vëmendje maksimale çdo ankese.
6. Transparenca mbeti një prioritet i qëndrueshëm, që do vijojë edhe gjatë vitit 2023, si në komunikimin publik të dedikuar, apo me aktivitete të parashikuara, marrëdhënies bashkëpunuese me mediat, në adresimin e interesit të tyre, si ndërmjetës me publikun, për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
7. Edhe gjatë vitit 2022 ILD ka ruajtur, përkundër kritikave në jo pak raste, komunikimin e balancuar, ndërmjet ruajtjes së konfidencialitetit me qëllim garantimin e integritetit të figurës së magistratit dhe të drejtës për informim.
8. Bashkëpunim dhe forcim të marrëdhënieve institucionale me organet e sistemit të drejtësisë,

në konsolidimin e veprimtarisë dhe rritjen e efikasitetit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit të nevojshëm për të përmirësuar proceset e rëndësishme siç janë hetimi disiplinor dhe vlerësimi etik dhe profesional i magistratëve.

9. Bashkëpunimi me çdo faktor/aktor të shoqërisë civile, jo vetëm si mjet kontrolli për punën e institucionit, por edhe si partnerë, përmes aktiviteteve të dedikuara mbi rolin dhe funksionet e ILD-së, sfidat e përparimit në funksion të forcimit të besimit publik tek sistemi i drejtësisë.
10. Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, si në drejtim të rritjes së kapaciteteve të Zyrës së ILD-së, shkëmbimit të praktikave më të mira të punës, por dhe në drejtim të përcjelljes së ecurisë dhe arritjeve të vendit, nga reforma në sistemin e drejtësisë në tërësi.
11. Në mungesë të një praktike të konsoliduar administrative si dhe gjyqësore, institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka luajtur një rol të rëndësishëm lidhur me interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri mbi përgjegjësinë disiplinore të magistratëve. Gjatë vitit 2022, sikundër edhe në periudhat e mëparshme, nuk ka patur asnjë pretendim të ngritur ndaj ILD-së, ndaj veprimtarisë hetimore të institucionit, për shkaqe jashtë atyre që parashikon ligji. Madje standardet e vendosura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për verifikimin dhe hetimin janë certifikuar, si nga këshillat (KLGJ e KLP), ashtu edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Edhe në këtë raport sfida për institucionin vazhdojnë të mbeten:

1. Përfundimi i trajtimit të dosjeve të Backlog, për shkak të volumit që zë në ngarkesë.
2. Mungesa e burimeve njerëzore mbetet një sfidë permanente.

Veprimtaria institucionale njëvjeçare, dëshmon se viti 2022 ka patur rezultate pune dhe ecuri të qëndrueshme. Krahas rezultateve të përmendura në rubrikat e ndryshme të këtij raporti, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i ndërgjegjshëm se progresi i mëtejshëm mund të arrihej edhe në këto drejtime:

1. **Rritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale të inspektorëve.** Krahasur me vitin 2021, numri i trajnimeve ka qenë më i reduktuar. Kjo edhe për shkak të prioritetit të vendosur për të përqendruar Njësinë e Inspektorëve në shqyrtimin e ankesave dhe pastrimin e backlog-ut. Nga ana tjetër, pavarësisht përpjekjeve dhe parashtrimit të nevojave, sigurimi i trajnimeve me ekspertë dhe profesionistë të fushës, mbetet një sfidë e vazhdueshme, pasi nuk ka kurrikula apo mekanizma, që në mënyrë permanente ofrojnë trajnime në fushën e inspektimeve. Pjesëmarrja në forume (konferenca), ku diskutohen tematika në funksion të shërbimeve të inspektimit, kërkojnë angazhim shumëdimensional dhe kanë kosto të larta administrimi.
2. **Përshtatja e përvojës ndërkombëtare dhe shkëmbim i eksperiencave apo praktikave të punës të marra deri më tani.** Këto eksperiencë kërkojnë kohën e vet, për t'i përshtatur në praktika dhe standarde pune, të cilat më pas do të sigurojnë rezultate në vijimësi dhe koherencë të veprimtarisë, me përvojat më të mira evropiane. Standardet e punës të krijuara

deri më tani, duhet t'i nënshtroheshin vlerësimit nga organet e sistemit përmes indikatorëve specifikë.

- 3. Aspekte të zhvillimit të infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit,** janë një sfidë tjetër e cila duhet të shënonte arritje. Gjatë vitit 2022, nuk ka patur zhvillime domethënëse, kjo për shkak të projektit të rikonstruksionit dhe kohës së zgjatur për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor, për të modernizuar mjedisin e punës, ku padyshim janë marrë masa për të siguruar infrastrukturën e nevojshme të teknologjisë.



## **X. PRIORITETE GJATË VITIT 2023**

1. Përfundimi brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023 të ankesave të Backlog.
2. Matja e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë.
3. Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit dhe strategjisë së menaxhimit të rasteve.
4. Përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme të teknologjisë së informacionit, në veçanti për verifikimin e ankesave dhe inspektimeve.
5. Krijimi i historikut për të dhënat e institucionit ndër vite dhe auditimi i performancës.
6. Forcimi i mekanizmave institucionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të subjekteve të procedimit disiplinor.
7. Rritja e kapaciteteve të inspektorëve nëpërmjet implementimit të eksperiencave dhe përvojave më të mira të institucioneve të huaja me të njëjtën fushë veprimi, me qëllim përmirësimin e procesit të punës në trajtimin e ankesave, procesit hetimor etj.
8. Kryerja e inspektimeve të vazhdueshme tematike dhe institucionale të planifikuara, duke zhvilluar metodologjitë dhe standardet përkatëse.
9. Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë me të cilat ILD bashkëpunon.
10. Plotësimi i vendeve vakante në trupën e inspektorëve (magjistratë dhe jomagjistratë) me qëllim rritjen e efikasitetit në realizimin e objektivave të ILD-së.

## **XI NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2021.**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në respektim të vendimeve nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj” dhe nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, si dhe bazuar në ecurinë e punës së ILD-së, ka bërë një vlerësim të detajuar të raportit vjetor të punës të depozituar pranë tij nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për periudhën janar-dhjetor 2022.

Në seancën plenare të datës 14 korrik 2022, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2021”, përmes së cilës janë lënë për ndjekje dhe zbatim 11 rekomandime.

Me miratimin e rezolutës, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është hartuar kalendari i masave për zbatimin e rekomandimeve, janë caktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e masave për secilin rekomandim dhe afatet përkatëse për përmbushjen e rekomandimeve.

Nga rekomandimet e lëna sipas rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në një sintezë të nivelit të zbatimit të tyre, vëmë në dijeni se:

- prej tyre janë përmbushur (rekomandimet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7, 9, 10 dhe 11);
- rekomandimet e tjera janë realizuar pjesërisht dhe mbeten në proces për realizimin përfundimtar gjatë vitit 2023 (rekomandimet 6 dhe 8).

Për sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve dhe masave të marra në zbatim të tyre, në mënyrë të detajuar informojmë sa vijon:

- 1. Hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, si dhe bërjen publike të informacionit të pjesshëm sipas përcaktimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje dhe në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Në lidhje me rekomandimin nr. 1, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas marrjes në dorëzim me nënshkrimin e marrëveshjes së transferimit të aseteve mes drejtueses së misionit dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe bërjes pjesë të inventarit të aseteve të Zyrës së ILD-së, të sistemit, ka miratuar urdhrin nr. 59, datë 15.07.2022, “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe

përdorimin e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore (SMAD) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, e aksesueshme në linkun vijues:

<https://ild.al/wp-content/uploads/2022/07/Urdher-Nr.-59-date-15.07.2022-Rregullore-SMAD.pdf>

Nga ana e ILD-së, janë bërë kërkesa buxhetore pranë MFE-së për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit dhe rinovimin e licencave përkatëse, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së sistemit dhe përmbushjen e qëllimeve të tij.

2. *Vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe hartimin e një metodologjie të përgjithshme inspektimi.*

Në lidhje me këtë rekomandim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar:

- urdhrin nr. 122, datë 30.12.2022 “Për përcaktimin e rregullave për shqyrtimin e ankesave në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”

- urdhrin nr. 121, datë 30.12.2022 “Për miratimin e metodologjisë së inspektimit”.

3. *Vijimin me ritme të shpejta të punës për përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Lidhur me këtë rekomandim nga ana e Këshillave nuk ka patur komandime të magjistratëve si inspektorë magjistratë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ndërkohë që në lidhje me inspektorët jomagjistratë, në tetor 2022 janë mbyllur procedurat e rekrutimit me emërimin e 4 inspektorëve të rinj, duke e çuar numrin e inspektorëve në institucion në 12, nga të cilët, 4 janë inspektorë magjistratë dhe 8 inspektorë jo magjistratë.

4. *Nxitjen e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm ose institucione të tjera për paraqitjen e kërkesave të motivuara nga ana e tyre për realizimin e inspektimeve tematike apo institucionale nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, gjatë vitit 2022 ka mbyllur me sukses dy prej inspektimeve të iniciuara gjatë vitit 2021, një prej të cilëve është me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm. Rekomandimet e lëna nga këto inspektime do të ndiqen nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe rezultatet e tyre do të monitorohen gjatë vitit 2023.

Për vitin 2022, nuk janë paraqitur kërkesa nga organet kompetente.

5. *Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të inspektimeve institucionale e tematike dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit.*

Për sa i takon këtij rekomandimi, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është miratuar plani vjetor i inspektimeve për vitin 2023 dhe është publikuar në faqe.

- Vijimin me ritme të shpejta të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare, si dhe trajtimin me përparësi të ankesave, të cilat për shkak të parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” mund të parashkruhen, duke shmangur kështu arkivimin e tyre pa bërë të mundur verifikimin dhe hetimin nga institucioni.*

Gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar **534** ankesa backlog. Trajtimi i backlog-ut të mbetur është planifikuar të mbyllet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023.

- Ndjekjen me prioritet të ankesave ndaj magjistratëve në proces vettingu në funksion të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së tyre.*

Gjatë vitit 2022 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kanë ardhur 14 kërkesa, për 14 subjekte, për të cilat ILD ka vijuar trajtimin e tyre me prioritet.

- Trajtimin me prioritet të të gjitha rasteve të konfliktit të interesit që mund të ndeshen gjatë aktivitetit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.*

Gjatë vitit 2022 janë bërë përpjekje për nënshkrimin e një marrëveshje me ILDKPI-në për të trajtuar inspektorët e ILD-së për aspekte të kryerjes së verifikimeve në kuadër të parashikimeve të nenit 124/1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Projekt marrëveshja do të finalizohet gjatë vitit 2023.

- Rishikimin e objektivave të punës dhe hartimin e një plani të ri strategjik, të shtrirë në kohë dhe sipas një metodologjie të bashkërenduar për të shërbyer si një bazë për planifikim të përgjithshëm dhe për menaxhimin e performancës.*

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, me urdhrin nr. 63, datë 28/07/2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit 2023-2025, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u ngrit grupi i punës për hartimin e planit të ri strategjik të ILD-së, i cili ka hartuar draft planin strategjik. Draft plani strategjik aktualisht është duke iu nënshtruar konsultimit me ekspertë të huaj nga OPDAT. Plani i ri strategjik është hartuar në referim të një planifikimi të harmonizuar me sisteme të menaxhimit financiar dhe kontrollit, integritetit dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin operacional, me qëllim garantimin e përmbushjes me efikasitet dhe efektivitet të përgjegjësive dhe kompetencave.

Plani i ri parashikon një sërë masash dhe aktivitete të rishikuara dhe mban në konsideratë:

- Problematikat e realizimit të masave dhe aktiviteteve të porealizuara apo pjesërisht të realizuara nga plani 2020-2022;
- Rekomandimet e Progres Raportit për Shqipërinë;
- Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025.

*10. Angazhimin në kryerjen e kontrollit të brendshëm në mënyrë periodike, kryesisht në llogaridhënien e inspektorëve.*

Në lidhje me këtë rekomandim zhvillohen takime periodike javore, për të diskutuar problematikat dhe qasjet e vijimit të punës në Njësinë e Inspektorëve.

Krahas takimeve periodike, është propozuar edhe ndryshimi në strukturë duke ngritur një njësi që ka për qëllim realizimin me cilësi të proceseve të vazhdueshme në fushat e punës analitike dhe kërkimore për standardizimin e procesit të punës në çdo strukturë nëpërmjet përgatitjes së manualeve të brendshme dhe standardeve specifike me qëllim përcaktimin, përditësimin dhe analizimin e indikatorëve që masin performancën e institucionit në mënyrë periodike, do të mundësojë që raportet, analizat, informacionet etj., të shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim rritjen e efikasitetit dhe uljen e çdo risku të mundshëm që ndikon në performancën e ILD-së si dhe qëllimit të krijimit të tij, si dhe grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore me qëllim realizimin e raporteve me informacionin e nevojshëm lidhur me veprimtarinë e institucionit.

Gjatë vitit 2022, janë përgatitur aktet e nevojshme për fillimin e vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve, proces i cili pritet të fillojë në 3-mujorin e dytë të vitit 2023 dhe të përfundojë në dhjetor 2023. Fillimi i këtij procesi do të shënojë vlerësimet e para të performancës së inspektorëve.

*11. Vijimin dhe rritjen e transparencës ndaj publikut nëpërmjet përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit publik. Marrëdhënia me publikun është një nga mënyrat më efektive për të krijuar një reputacion solid të institucionit.*

Për të përmbushur rekomandimet që rrjedhin nga rezoluta e Kuvendit në lidhje me rritjen e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët janë ndërmarrë këto masa:

1. Prezenca e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mediat televizive është rritur ndjeshëm, me fokus sqarimin e rolit dhe funksioneve të ILD-së edhe në raport me aktualitetin e dinamikave publike, të cilat kanë patur në vëmendje institucionet e drejtësisë apo vetë ILD-në. Mesazhet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë publikuar në formë videosh të shkurtra, si në faqen zyrtare të institucionit, kanalin *youtube*, ashtu edhe në rrjete sociale, sipas tematikës së caktuar. Kjo për një asimilim më të mirë të mesazhit të targetuar dhe angazhimi i shikuesve/lexuesve ka qenë tregues se kjo mënyrë komunikimi ka funksionuar.

2. Përmirësimi dhe përditësimi i informacionit në faqen zyrtare të internetit [www.ild.al](http://www.ild.al) në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Janë krijuar lehtësi në hulumtimin e publikut dhe palëve të interesuara në lidhje me:
  - a) pasqyrimin në kohë reale të çdo aktiviteti në rubrikën “Njoftime”.
  - b) pasurimi me informacion të rubrikës “Si pranohen ankesat”, në të cilën jepet informacion i dedikuar se si bëhet një ankesë dhe hapat që ndiqen më pas. Formulari TIP i ankesës dhe udhëzuesit për plotësimin e saj, shoqërohet me ilustrime për ta saktësuar këtë proces.
  - c) publikimi i një sërë shembujsh mbi vendimet që merr Inspektori i Lartë i Drejtësisë për raste të pranimit të ankesave.
  - d) ilustrimi grafik i ecurisë së një ankese në ILD ndihmon në të kuptuarit më të mirë të këtij procesi nga çdo qytetar.
3. Për të marrë mendimin direkt të qytetarëve për punën e ILD, pavarësisht nëse kanë patur apo jo eksperiencë personale me ne, në ditën e drejtësisë, më 10 Maj 2022 është publikuar një anketë, e cila përmes pyetjeve të thjeshta e me mundësi të hapura përgjigjesh, synon të kuptojë se si po ecën procesi i ndërgjegjësimit dhe edukimit publik në të kuptuarit drejtë të sjelljeve që i japin shkak procedimit disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe si mund të përmirësohet puna e ILD-së në nivel dhënie shërbimi.

Deri në datën 31 Dhjetor 2022, janë plotësuar nga përdorues të shërbimeve të ofruara nga ILD, 49 anketa. Krahasuar me 500 ankesat e konfirmuara gjatë kësaj periudhe, rezulton se 10% e përdoruesve të kenë ndarë përmes anketës përvojën e tyre sa u përket shërbimeve të ofruara nga ana e ILD-së. Të dhënat e anketës do i shërbejnë institucionit për të rikonfiguruar mënyrën e informimit publik mbi rolin dhe funksionet e ILD-së, pikërisht përmes pyetjeve që adresohen më shpesh si nga qytetarë ashtu edhe nga vetë mediat.
4. Me urdhrin nr. 49, datë 30.05.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u miratua programi për informimin dhe komunikimin publik, i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në të cilin parashtrohen si objektiva bazë: ofrimi i asistencës për ankuesit; promovimi i veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; garantimi i të drejtës së informimit dhe transparencës, si dhe monitorimi i qasjes së publikut ndaj veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.